

MENDIM PAKICE

1. Unë, komisionere Brunilda Bekteshi, kam votuar kundër vendimit të shkarkimit të marrë nga shumica e trupit gjykues në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Enkeleda Kapedani, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkak se subjekti i rivlerësimit, sipas vlerësimit të pakicës, arriti nivel të besueshëm në kriteret e rivlerësimit, për rrjedhojë subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Kapedani duhej konfirmuar në detyrë, pasi në mënyrë kumulative plotësonte të tria kushtet e parashikuara të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, duke arsyetuar sa vijon:

1.1 Si pakicë kam vlerësuar në ndryshim nga konkluzioni i shumicës për pasurinë e përshkruar në pikën 45 të vendimit, deklaruar nga subjekti vlera prej 28.000 euro, dhënë me kontratën e huas nr. ***, datë 17.1.2017, shtetasit L.L.

1.2 Ndryshe nga shumica e trupit gjykues kam arritur në një konkluzion tjetër për sa i përket: (i) vlerësimit të saktësisë së deklarimeve dhe burimeve të gjendjes *cash* në shumën 400.000 lekë nga bashkëjetuesi i subjektit, pas kryerjes së disa transaksioneve financiare; (ii) vlerësimit të saktësisë dhe ligjshmërisë së burimit të krijimit të huas nga të ardhurat e përfituara nga shitja e mjetit kamion; si dhe (iii) vlerësimit të veprimeve juridike të kryera nga bashkëjetuesi, pra shitblerjes së mjetit kamion, kontratës së huas, ku gjendja *cash* prej 400.000 lekë ndërli dhej/mbetej nga kjo hua.

1.3 Lidhur me saktësinë e deklarimeve për të cilën shumica arsyeton se *nga ana e subjektit, në parashtrimet e saj, është shpjeguar se huaja është dhënë në muajin nëntor të vitit 2016. Ky fakt nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën Vetting nga bashkëjetuesi i subjektit, i cili në këtë deklaratë ka deklaruar se huaja është dhënë me kontratë huaje datë 17.1.2017, vlerësoj¹ se ky konstatim nuk qëndron. Kjo për shkak se nga një lexim i saktë dhe korrekt i deklarimeve të subjektit/personit të lidhur me të, si dhe nga analizimi i provave të administruara, në raport me kontrollin e mundësive për burime të ligjshme për krijimin e pasurisë së deklaruar, drejtpërdrejtën konkludohet në një vlerësim ndryshe që në çmuarjen e gjendjes faktiko - juridike që janë provat i përgjigjen të vërtetës objektive. Për të gjitha argumentet që prezantoj në vijim, ky konkluzion i shumicës nuk mund të përfshihet në vlerësimin tërësor të këtij hetimi administrativ, pasi gjatë procesit të rivlerësimit për këtë subjekt:*

1.4 Rezultoi e provuar se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, bashkëjetuesi i saj, ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, gjendjen *cash* në shumën 400.000 lekë, duke detajuar² të gjitha

¹ në zbatim të parashikimit të bërë në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

² Specifikisht ka deklaruar Gjendje *cash* ne shumen 400,000 (katerqind mije) leke perfituar nga shitja e nje mjete i llojit kamion sipas Kontrates se Shitjes nr. *** Rep, nr. *** Kol, dt 13.10.2016 i cili ishte blere me kontraten e blerjes nr. *** Rep, nr. *** Kol dt 29.04.2016 burimi i blerjes se pasurise eshte bashkejetuesja ime Enkeleda Kapedani, te ardhura nga shitja e pasurise se saj nr.*** pasurie, ZK ***, Adresa: ***, Lushnje, shitur me Kontraten Noteriale nr.*** rep, nr.*** kol, dt 27.05.2011. Cmimi i shitjes se kamionit eshte 32,000 (tridhjetë e dy mije) Euro nga te cilat jane gjendje cash vetem 400,000 (katerqind mije) leke ndersa shuma prej 28,000 (njezet e tete mije) Euro jane dhene hua sic eshte specifikuar ne piken nr.4 si me poshte vijon.

4. Vlera prej 28,000 (njezet e tete mije) Euro dhene me Kontraten e Huase nr.*** Rep, nr.*** Kol dt 17.01.2017 shtetasit L.L, si dhe Aneks Kontrate nr.*** Rep, nr.*** Kol dt 26.01.2017 e cila ka ndryshuar dy kushte te kontrates se Huase se dates 17.01.2017 ne lidhje me afatin duke percaktuar perfundimisht afatin 6 mujor per kthimin e huase, si dhe ne lidhje me interesin duke e lene huane pa interes. Kjo pasuri ka ardhur nga shitja e nje mjete i llojit kamion me kontraten e shitjes nr.*** Rep, nr.*** Kol, dt 13.10.2016 i cili ishte blere me kontraten e blerjes nr.*** Rep, nr.*** Kol dt 29.04.2016, burimi blerjes se kësaj pasurie eshte bashkejetuesja ime Enkeleda Kapedani te ardhur nga shitja e pasurise se saj nr.*** pasurie, ZK ***, Adresa: ***, Lushnje, shitur me Kontraten Noteriale nr.*** rep, nr.*** kol, dt 27.05.2011

veprimet mbi shitjen e mjetit kamion dhe dhënien e huas, e cila është formalizuar me akt noterial/kontratë huaje, në datën 17.1.2017 dhe që, për pasojë, ka mbetur gjendje kjo shumë.

1.5 Nga leximi i deklaramit të bërë në raport me të dhënat faktike të dala nga provat, provohet që të ardhurat nga shitja e mjetit/kamion nuk kanë qenë gjendje *cash* në datën 31.12.2016, pasi ky fakt është shprehur qartësisht në deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.7.2018, në përmbajtje të së cilës me vullnetin e tij të lirë, huamarrësi shtetasi L.L ka deklaruar se ai ka marrë hua nga bashkëjetuesi i subjektit në muajin nëntor të vitit 2016, me kontratë huaje verbale.

1.6 Në vlerësimin tim, ky fakt/deklarata konsiderohet i dhënë me vërtetësi të plotë, pasi është shoqëruar me fletën nga regjistri noterial ku akti rezulton i regjistruar dhe, po ashtu, është një deklaratë e lëshuar në momentin kur ndaj subjektit të rivlerësimit ende nuk kishte nisur procedura e rivlerësimit³. Gjithashtu, fakti që nga bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit, kontrata e huas është deklaruar edhe në deklaratën për vitin 2016, për shkak se kjo e fundit është depozituar në mars të vitit 2017, kohë në të cilën ishte realizuar kontrata e huas, është një tjetër element që mbështet faktin se huaja është dhënë në vitin 2016 dhe se ajo nuk ka qenë gjendje *cash* në fund të këtij viti.

1.7 Në këto kushte provohet bindshëm se huaja i është dhënë shtetasit L.L në muajin nëntor 2016 me anë të një kontrate verbale, si dhe duke iu referuar përmbajtjes së kontratës së huas nr. ***, datë 17.1.2017, në të cilën është parashikuar: “... *palët deklarojnë se dorëzimi i vlerës së huas, është bërë jashtë kësaj zyre noteriale*”. Sipas neneve 1050 - 1055 të Kodit Civil, që rregullojnë parashikimet kontraktore të huas, rezulton se kontrata e huas është një kontratë joformale, ku vullneti i palëve mund të shfaqet në çdo formë, verbalisht, me shkrim, me heshtje apo me veprime konkludente. Këto nene të Kodit Civil nuk kërkojnë në mënyrë të veçantë dhe të shprehur që shprehja e vullnetit për lidhjen e kontratës së huas të vishet me një formë të caktuar. Sipas këtyre dispozitave ligjore, vullneti i palëve mund të shfaqet në çdo formë, mjafton që të rezultojë dhe të identifikohet qartë qëllimi i tyre dhe interesi për lidhjen e kontratës. Në këtë drejtim, formalizimi i kësaj kontrate kryhet vetëm për efekt provueshmërie.

1.8 Sa më sipër, të njëjtin qëndrim mban edhe Kolegji në vendimin nr. 20/2019 ku, ndër të tjera, arsyeton se: “*Kolegji analizoi rrethanat e faktit të cilat kanë rezultuar nga hetimi, në këndvështrim të dispozitave ligjore që rregullojnë situatën e mësipërme. Në këtë kontekst, Kolegji vlerëson se kontrata e huas e formalizuar në formë shkresore të thjeshtë, është një formë e lejuar për të provuar ekzistencën e kësaj marrëdhënieje, në kuptim të dispozitave të Kodit Civil, respektivisht nenet 1050-1055, të cilat nuk parashikojnë për efekt të vlefshmërisë së saj një formë të caktuar shkresore, duke e përfshirë këtë veprim juridik të kontratave joformale. Gjithashtu vetë neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënieje, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, duke pranuar se marrëdhëniet e pretenduara sipas kësaj dispozite jo detyrimisht duhet të jenë të formalizuara në një formë të caktuar, sigurisht përveç rastit kur forma e tyre është e detyrueshme për vlefshmërinë e tyre, sipas përcaktimit të Kodit Civil, për sa kohë që për provimin e ekzistencës së tyre, në kuptim të këtij procesi, kërkohet konfirmimi i personit tjetër të lidhur*”.

1.9 Në vlerësimin tim, vullneti i palëve në dhënien e huas, në rastin konkret, ka qenë në mënyrë heshtësore, sipas parashikimit ligjor⁴, bërë në Kodin Civil. Aktet formalizohen para noterit në mënyrë që palët të ndjekin rrugët ligjore në rast mosrespektimi të kthimit të huas, interesave, apo mosrespektim të afateve kur vullneti i tyre e dikton këtë kërkesë.

³ Deklarata daton në datë 24.07.2018, ndërsa subjekti është shortuar nëntor 2019.

⁴ Referuar nenit 1050 të K.Civil

1.10 Kam konstatuar se bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në të njëjtën mënyrë si në deklaratën për vitin 2016 dhe në deklaratën *Vetting*, duke cilësuar pikërisht faktin se ai ka dhënë hua shumën 28.000 euro, pavarësisht se në deklaratën *Vetting* pasqyron kontratën e huas nr. ***, datë 17.1.2017 si akti final i formalizimit dhe nuk ka specifikuar kohën se huaja është dhënë në vitin 2016.

1.11 Për sa më sipër, duke konsideruar se niveli i provave të administruara është i mjaftueshëm, konkludoj se huaja është dhënë në vitin 2016 dhe se ky fakt nuk mund të mos pranohet vetëm me argumentin se në deklaratën për veting është deklaruar shuma 28.000 euro me kontratën noteriale nënshkruar në janar 2017, përsa kohë në të dy deklaratat që pasojnë njëra tjetrën gjendja *cash* prej 400.000 lekë është deklaruar ekzaktësisht në të njëjtën vlerë. Arritja në konkluzionin e shumicës në vlerësimin tim, është fokusuar ngushtësisht në rakordimin e dy deklarimeve në deklaratat përkatëse, ndërsa në fakt për këtë çështje është kryer hetim dhe janë administruar prova të mjaftueshme. Nën këtë analizë, në ndryshim nga përfundimi i arritur nga shumica, çmoj se nga faktet e rezultuara, ky deklarim i personit të lidhur me subjektin, nuk arrin një nivel të tillë për tu kualifikuar si deklarim i pasaktë.

1.12 Nuk dakordësohem me vlerësimin e shumicës se veprimet e kryera midis bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit L.L për shitblerjen e kamionit, nuk përputhen me logjikën ekonomike.

1.13 Vlerësimi im, ndryshe në këtë rast, i referohet provave të administruara, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit që, më tej, në tërësinë e analizës së tyre më krijojnë bindjen e brendshme, që në rastin në fjalë, rrethanat faktike të çështjes nuk të çojnë në konkluzionin e arritur nga shumica, për sa arsyetohet në vijim.

1.14 Lidhur me këtë çështje, përgjatë hetimit administrativ u provua se shoqëria “***” sh.p.k. ka blerë një mjet kamion në vlerën 1.100.000 lekë nga një tjetër shoqëri, veprim ky i konstatuar i rregullt, i formalizuar me faturë tatimore mes shoqërive dhe më pas e ka shitur atë në shumën 950.000 lekë, gjithashtu, veprim ky i formalizuar me kontratë shitjeje mes shoqërisë “***” sh.p.k. dhe individit/bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit.

1.15 Më tej, rezultoi se bashkëjetuesi i subjektit këtë kamion ia ka shitur shtetasit A.V në vlerën 32.000 euro.

1.16 Mospërputhja e logjikës ekonomike në shitjen e mjetit në shumën 32.000 euro nuk qëndron, pasi shitësi, pra bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit e ka shitur mjetin me kontratë të rregullt ligjore, ku vlera e shitjes është përcaktuar me vullnet të lirë të palëve. Nga hetimi u provua se vlerat për mjete të tonazhit të rëndë, sikurse është rasti varionin në çmime relativisht të larta. Po nga hetimi u provua se blerësi fundor ruajti thujtë të njëjtin trend shitjeje të mjetit duke ia shitur shoqërisë së tij në shumën 30.000 euro. Lidhur me konfirmimin e një çmimi të lartë edhe shumica ka pranuar mbi provat e depozituara nga subjekti⁵ se minimalisht çmimi

⁵ Kontratën e shitjes nr.*** rep, nr.*** kol, dt 13.03.2015 për shitjen e një mjeti tip Kamion marka ***, vit prodhimi 2001 me një vlerë prej 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë. Faturën Tatimore të Shitjes nr.*** dt 05.09.2013 për shitjen e dy mjeteve tip Kamion *** ku secili prej tyre ka vlerën prej 4,300,000 (katër milion e treqind mijë) lekë secili duke kapur në total vlerën prej 8,600,000 (tetë milion e gjashtëqind mije) lekë. Faturën Tatimore të Shitje nr.*** dt 21.04.2021 për shitjen e një mjeti tip Kamion *** vit prodhimi 2006 i cili kap vlerën prej 2,600,000 (dy milion e gjashtëqind mijë) lekë Faturën Tatimore të Shitjes nr.*** dt 22.10.2021 për shitjen e një mjeti tip Kamion *** me vlerë 24,000 (njëzet e katër mijë) Euro. Faturën Tatimore të Shitjes nr.*** dt 22.10.2021 për shitjen e një mjeti tip Kamion *** me vlerë 11,000 (njëmbëdhjetë mijë) Euro. Akt Shitje dt 01.11.2019 për mjetin tip kamion *** vit prodhimi viti 2008 me vlerë 12.000 (dymbëdhjetë mijë) Euro. Konfirmimin bankar dt 12.04.2021 nga OTP Bank. Listë të ardhurash të shoqërisë së shtetasit L.L. Librin e blerjeve të shoqërisë *** shpk. Deklaratën Noteriale nr.*** rep, nr.*** kol, dt 24.07.2018 e shtetasit L.L. Foto te fletës së regjistrimit noterial ku është regjistruar kjo deklaratë noteriale. Kontrata shitje të ngjashme për mjete tip kamion si vioj: Kontrata e shitjes nr.*** rep, nr.*** kol, dt 13.03.2015; Faturë Tatimore Shitje nr.*** dt 05.09.2013; Faturë Tatimore Shitje nr.*** dt 21.04.2021;

varionte nga 19.000 euro deri maksimalisht në 35.000 euro. Në këtë pikë, evidentoj faktin e qenësishëm se mospërputhmëria e logjikës ekonomike do të qëndronte vetëm në shitblerjen e mjetit mes bashkëjetuesit të subjektit dhe shtetasit V, por kjo do të rezultonte e tillë vetëm nëse nuk do të gjendeshim përpara çmimeve të larta referuese të tregut.

1.17 Nuk dakordësohem me shumicën kur vlerëson se Komisioni i ka kaluar subjektin barrën e provës, pikërisht, për atë që ajo me pretendimet e saj ka dashur të provojë, pra që për Komisionin ka qenë e dyshimtë që një automjet është blerë në shumën 950.000 lekë dhe është shitur 32.000 euro, pasi çdo dyshim i ngritur përgjatë këtij procesi i nënshtrohet hetimit të plotë dhe të gjithanshëm që ka për fokus mbledhjen e të gjitha të dhënave dhe shqyrtimin e tyre me objektivitet, analizës së provave dhe, në përfundim të procesit, arrihet në konkluzione që pasjellin vendimmarrjen, në përmbushje të kompetencës që njihet ligji.

1.18 Në rastin konkret, veprimi i kryer mes bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit A.V duhet parë i ndarë nga veprimi i shitjes së mjetit mes shtetasit L dhe bashkëjetuesit të subjektit. Vlerësoj se në ndërmarrjen e veprimeve të rezultuara nga ky hetim, bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë i detyruar të shesë mjetin e blerë në të njëjtën vlerë, për sa kohë rezultoi se tregu i shitblerjes identifikonte vlera, të cilat varionin dhe jepnin mundësinë e shitjes në atë vlerë, duke qenë një mjet i tonazhit të rëndë, i cili ka rezultuar se nga blerësi fundor është pasqyruar edhe në pjesëmarrjen e tij nëpër prokurime publike⁶.

1.19 Në këto kushte, për sa kohë u provua: (i) ekzistenca e vlerës së lartë të shitjes së këtij lloji mjeti; (ii) tjetërsimi i pasurisë nëpërmjet institucionit përkatës DPSHTRR-së dhe nuk u identifikua ndonjë raportim në DPPPParave për ndonjë dyshim të mundshëm në shitblerjen e kësaj pasurie nga 950.000 lekë në 32.000 euro, atëherë çdo dyshim i ngritur i paprovuar nuk mund të përbëjë rrethana për penalizimin e subjektit.

1.20 Po ashtu, pretendimi i subjektit se blerja e automjetit nga bashkëjetuesi i saj ishte okazion për arsye se shitësi kishte probleme financiare nuk mund të vlerësohet si një moment detyruar për blerësin, i cili domosdoshmërisht duhet të refuzonte çmimin e tregut për t'i qëndruar strikt vlerës së blerjes.

1.21 Në vijim, ndaj qëndrim ndryshe sa i takon vlerësimit të shumicës se pretendimi që shtetasi L.L ishte gjendur në vështirësi financiare ndaj kishte shitur mjetin në shumën 950.000 lekë nuk qëndron, pasi shoqëria e tij nuk rezultoi të ketë pasur probleme financiare. Për këtë vlerësim shumica i është referuar pasqyrave financiare të vitit 2016 të aksesuara nga ekstrakti historik në QKB.

1.22 Në vlerësimin tim, ky konkluzion nuk qëndron, pasi për sa kohë shitblerja e mjetit nga shtetasi L te bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit nuk pasqyroj ndonjë parregullsi, hetimi i kryer lidhur me qenien ose jo në vështirësi financiare të shtetasit L merr vlerë vetëm për faktin nëse shpjegimet e subjektit kanë qenë bindëse, për të cilin hetimi nxori në pah faktet e mëposhtme.

Nga aksesi në QKB për shoqërinë “****” sh.p.k. rezultoi se aktualisht është me status “pezulluar”. Kjo shoqëri në datën 21.12.2018 ka bërë kërkesë për pezullim aktiviteti duke cituar: “... pasi nuk ka aftësi pagueuse për të përballuar fluksin e shpenzimeve mujore”.

1.23 Nga ana tjetër rezultoi se shtetasi L.L nuk ka vetëm këtë shoqëri, pra *** sh.p.k., por rezultoi se ai është ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë “****” sh.p.k. Nga të dhënat e aksesuara nga ekstrakti historik i kësaj shoqërie, rezultoi se kjo shoqëri është me humbje,

Faturë Tatimore Shitje nr.*** dt 22.10.2021; Akt Shitje dt 01.11.2019 për mjetin tip kamion *** vit prodhimi viti 2008 me vlerë 12.000 (dymbëdhjetë mijë) Euro.

⁶ [https://openprocurement.al/***\)](https://openprocurement.al/***))

minimalisht nga kërkimi i kryer prej viteve 2014 – 2017. Në vitin 2018 ka një fitim të papërfillshëm, prej 290.652 lekësh.

1.24 Në vlerësimin tim nuk duhet anashkaluar fakti që të dyja shoqëritë janë të shtetasit L.L, pasi një ortak i vetëm ka më shumë liri veprimi në shoqëritë e tij dhe mund t'i ndërthurë veprimet, aktivitetet apo transaksionet mes shoqërive.

1.25 Duke iu referuar pikërisht dokumentacionit provues lidhur me vështirësitë financiare të shtetasit L, të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në prapësime, konfirmohet që të ardhurat e shoqërisë “****” sh.p.k. me pronar L.L pas vitit 2011 kanë pësuar rënie. Ky fakt, gjithashtu, provohet po nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti, më konkretisht, konfirmimi nga OTP Bank se shtetasi L.L ka marrë në datën 11.5.2018 kredi në vlerën 12.000.000 lekë.

1.26 Në këtë rrjedhë arsyetimi provohet, gjithashtu, fakti se koha e marrjes së kredisë rakordon me shlyerjen e huas nga shtetasi L, bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit, duke iu referuar në këtë rast deklaratës noteriale të vitit 2018, kur dhe citohet shlyeja e huas. Po ashtu, problematika e vështirësisë ekonomike e shtetasit L.L pasqyrohet edhe në dokumentacionin⁷ e administruar nga Komisioni për çështjen e trajtuar në rubrikën “Gjetje të tjera” të vendimit të shumicës.

1.27 Unë, si komisionere në pakicë, nuk dakordësohem me vlerësimin e shumicës, *se nëse z. L do të ishte në vështirësi ekonomike ai mund të merrte kredi, sikundër ka ndodhur më vonë, dhe mund të priste momentin e duhur për të shitur automjetin dhe jo të shiste automjetin të bashkëjetuesi i subjektit për t'i marrë më pas hua vlerën e përfituar nga shitja e këtij automjeti, pasi zgjidhjet financiare për marrje kredie apo shitje asetesh nuk mund të imponohen për shkak se administrimi i shoqërive është përgjegjësi individuale e administratorit.*

Në lidhje me veprimet fiktive për automjetin kamion, të kryera nga bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit

1.28 Nuk bie dakord me vlerësimin e shumicës se ndryshimi i kontratës së huas brenda tre muajve, nga një kontratë me interes në një kontratë pa interes tregon sërish për veprime fiktive midis bashkëjetuesit të subjektit dhe z. L, pasi ndryshimi i kontratës së huas nuk është kryer brenda tre muajve, por brenda një harku kohor prej 9 ditësh, pra është nënshkruar kontrata e parë datë 17.1.2017, ku janë parashikuar edhe interesat dhe më pas është nënshkruar edhe aneksi i kontratës në datën 26.1.2017, ku përjashtohet me vullnet të palëve interesi mbi huan e dhënë. Duke iu referuar aneksit të kontratës vërehet se ky amendim është bërë nën kontekstin e gabimit të kryer nga noteri për shumën e interesit, pra duke qartësuar në këtë mënyrë faktin se përfitimi i interesave nuk ka qenë qëllimi i kontratës së huas. Por, edhe nëse do të gjendeshim përpara një revokimi kontraktor nga ana e palëve të një vullneti të mëparshëm, atëherë për sa kohë legjislacioni ka parashikuar marrëveshjen⁸ e palëve në marrëdhënien e huas, heqja dorë nga përfitimi i interesave nuk mund të etiketohet si veprim fiktiv. Në mbështetje të konstatimit tim është edhe fakti që fiktiviteti kërkon ardhjen e pasojës, që në këtë rast nuk u diktua ndonjë pasuri e fshehur apo investim paraprak.

1.29 Si pakicë nuk dakordësohem me vlerësimin e shumicës se subjekti dhe bashkëjetuesi i saj nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për t'i dhënë hua z. L shumën 28.000 euro, për rrjedhojë, çmimi i shitjes i vendosur në shumën 32.000 euro ka shërbyer për të justifikuar me burime të ligjshme dhënien e huas në shumën 28.000 euro. Në vlerësimin tim nëse vërtetë do të konsiderohej kjo situatë, sikurse e vlerëson shumica, atëherë subjekti/bashkëjetuesi i saj nuk do e kishte deklaruar huan e dhënë, aq më tepër nuk do ta kishte formalizuar atë, për shkak të qenies përpara një huadhënieje dhe jo huamarrjeje. E kundërta do

⁷ Përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 25.2.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸ Referuar nenit 1051 të K.Civil.

të ndodhte nëse do të gjendeshim përpara marrjes së një huaje nga subjekti/bashkëjetuesi i saj për të mbuluar ndonjë investim.

1.30 Vlerësoj ndryshe edhe përfundimin e nxjerrë nga shumica kur bashkëshoqëron marrëdhënien e shitblerjes së kamionit me atë të huas duke krijuar bindjen se kemi të bëjmë me marrëdhënie fiktive, parashikuar nga neni 92 i Kodit Civil, duke vlerësuar të gjitha veprimet e ndërtuara me qëllim për të justifikuar me të ardhura të ligjshme dhënien e huas në shumën 28.000 euro z. L, për të cilën, gjithashtu, ka krijuar bindjen për një skemë pastrimi parash.

1.31 Në këtë rast, në ndryshim nga shumica, kam krijuar bindjen se në raport me provat e administruara nuk ndodhemi përpara një marrëdhënieje fiktive dhe aq më pak përpara skemës së pastrimit të parave.

1.32 Gjatë hetimit nuk u provua se qëllimi i marrëdhënieve kontraktore ishte fshehja e një tjetër veprimi. Në pikëpamjen time, duke i quajtur fiktive kontratat, indirekt i quan ato joekzistenciale, por nga ana tjetër një seri veprimesh juridike kanë ndodhur dhe prej tyre kanë ardhur pasoja, të cilat në çdo rast janë deklaruar nga bashkëjetuesi i subjektit, pra është përfituar mjete, është shitur, janë krijuar të ardhurat dhe për to është deklaruar shuma e dhënë hua, si dhe gjendja *cash*.

1.33 Nisur nga sa më sipër, unë, si komisionere në pakicë, vlerësoj se fiktiviteti ka si bazë mungesën e vullnetit të vërtetë të ndërsjellë të palëve, si dhe qëllimin e tyre për realizimin e një përfitimi të paligjshëm.

1.34 Në vlerësimin tim, shumica nuk konkludon definitivisht në këtë çështje, pasi konstatoj se nga ana e saj/shumicës herë konkludohet se çmimi i blerjes është fiktiv pasi mjete të tilla kanë vlera më të larta në treg, herë konkludohet se çmimi i shitjes është fiktiv, pasi është shitur me vlerë disa herë më të lartë se blerja e tij, ndërsa kjo çështje për pakicën, duhej të vlerësohej nën analizën ligjore dhe faktike që është arsyetuar më sipër.

1.35 Duke u nisur nga vendimet e cituara nga shumica lidhur me çështjen e provueshmërisë së fiktivitetit konstatoj se vendimi nr. ***, datë 23.2.2022, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në raport me çështjen objekt hetimi, në vlerësimin tim nuk përkon me rrethanat e çështjes objekt vlerësimi. Ky vendim i Kolegjit, ndër të tjera, ka trajtuar mosdeklarimin e blerjes së mobilieve të banesës, të cilat më pas janë shitur në vlerë të lartë. Në çështjen objekt hetimi, rezulton se të gjitha veprimet juridike të kryera nga bashkëjetuesi i subjektit janë deklaruar në kohë reale, pra si blerja dhe shitja e mjetit. Këto veprime kanë sjellë pasojat juridike të dëshiruara prej tyre dhe për pasojë ato nuk mund të jenë fiktive dhe të kenë pasur për qëllim mbulimin e vullnetit/qëllimit të vërtetë të palëve pjesëmarrëse në to.

1.36 Po ashtu, duke iu referuar edhe dy vendimeve⁹ të tjera të cituara, sërish konstatoj se asnjëri prej tyre nuk përkon me situatën objekt hetimi, pasi në të dyja rastet bëhet fjalë për lidhje të dy kontratave të shitjes për të njëjtën pasuri, por duke ndryshuar çmimin.

1.37 Si komisionere në pakicë vlerësoj se vendimet e Kolegjit lidhur me fiktivitetin, të përdorura si referencë nga shumica, janë tërësisht jorelevante lidhur me rastin objekt shqyrtimi dhe se nga ana e subjektit dhe bashkëjetuesit të saj nuk janë kryer veprime juridike fiktive të ngjashme me ato që përshkruhen në vendimet e referuara nga shumica, për sa kohë nga faktet e dala nga hetimi nuk u identifikua shkaku i fiktivitetit, qëllimi i vërtetë i fshehur i palëve, si dhe përfitimet e paligjshme që ata kishin pasur si pasojë e këtyre kontratave.

1.38 Në mendimin tim, vlerësimi i shumicës se subjekti me veprimet e saj ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë nuk qëndron, pasi çmimi i referuar në kontratën e shitjes, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit më krijojnë bindjen për vlerën reale të shitjes.

⁹Nr. ***, datë 19.11.2018 dhe nr. ***, datë 23.9.2019.

1.39 Shumica ka konkluduar se: “Komisioni në lidhje me këtë marrëdhënie mban në konsideratë edhe faktin e kryerjes së veprimeve cash dhe pa asnjë dokument deri në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* nga ana e subjektit”.

1.40 Në lidhje me kryerjen e veprimeve *cash*, si komisionere në pakicë ndaj mendim ndryshe, se në rastin konkret veprimi juridik i shitjes së mjetit apo i dhënies dhe kthimit të huas janë kryer midis dy individëve, që nuk ushtrojnë veprimtari tregtare dhe që, për pasojë, nuk ekziston detyrimi ligjor për transfertën e çmimit nëpërmjet sistemit bankar. Ky detyrim ekziston vetëm për veprimet ndërmjet subjekteve tregtare¹⁰.

1.41 Vlerësimi im për këtë çështje nuk i është nënshtruar vetëm mjaftueshmërisë së provave, por është konkluduar në ndërthurje të plotë e të qartë me vlerësimin e vërtetësisë së tyre, për të arritur jo në një përfundim hipotetik, por në një të vetëm dhe të pakundërshtueshëm.

1.42 Jam kundër konstatimit të shumicës për krijimin e bindjes se ka një skemë të pastrimit të parave, pasi provat e administruara dhe provueshmëria e çmimit real të këtij mjeti kurrsesi nuk të çojnë në një përfundim të tillë. Në vlerësimin tim, në këtë çështje rezultojnë fakte që diktojnë këtë konkluzion ndryshe, pasi ka rezultuar se: (i) të gjitha veprimet mes palëve janë të identifikuar, të kryera para noterit publik, të konfirmuara edhe nga institucioni përkatës, DPSHTRR; (ii) janë të deklaruara ndër vite, në deklaratën *Vetting* dhe pas saj, përgjatë gjithë procesit të rivlerësimit; (iii) nga verifikimi dhe hetimi konstatohet se arrihet të gjurmohen të dhënat për dhënien dhe kthimin e huas, si dhe burimi i tyre; (iv) edhe pas verifikimit të deklaratave të viteve 2018 dhe 2019 e më tej nuk provohen investime në pasuri të tjera dhe se pasuritë e identifikuar edhe pas deklaratës *Vetting* rezultojnë me burime të ligjshme¹¹; (v) nuk evidentohen raste të përsëritura të shitjes së mjeteve.

1.43 Në përfundim, nën arsyetimin e mësipërm, si dhe në konsideratë të fakteve të pakontestueshme: (i) dhënia e huas pa interes; (ii) analizimi i DPV-ve të periudhës 2017 – 2020 nga të cilat nuk rezultoi që nga subjekti apo bashkëjetuesi i saj të jetë shtuar ndonjë pasuri për të cilën të kenë shërbyer si burim të ardhurat nga shitja e mjetit; (iii) mosshlyerja e asnjë detyrimi me këto të ardhura, në tërësi më krijojnë bindjen se veprimet nuk janë fiktive, pasi nuk provohet të jetë mbuluar ndonjë përfitim i paligjshëm dhe aq më pak të gjendemi para deklaramit të rremë, për të cilin shumica nuk ka dhënë asnjë argument faktik apo juridik, pse mund të kualifikohej i tillë.

Lidhur me impaktin që ka çështja e pagesës së tatimit në burim për diferencën mes çmimit të shitjes dhe blerjes.

1.44 Shumica, në vendimmarrjen e saj, ka konkluduar duke i quajtur deklaramet e subjektit kontradiktore kur është pyetur në lidhje me pagesën e tatimit mbi të ardhurat e krijuara nga diferenca e shitjes së automjetit nga ajo e blerjes, pasi fillimisht ka deklaruar se ky tatim nuk është paguar, më tej pas dërgimit të rezultateve të hetimit ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 21.10.2021, të DPT-së, sipas së cilës bashkëjetuesi i saj kishte deklaruar të ardhura në vitin 2016 në shumën 3.114.000 lekë dhe kishte paguar detyrimet tatimore në shumën 467.100 lekë dhe, në vijim, në seancë dëgjimore është përgjigjur se nuk kishte dijeni për datën e pagesës, por duke pretenduar në vijim se pavarësisht shlyerjes së pagesës bashkëjetuesi nuk ka pasur detyrim për të kryer këtë pagesë.

1.45 Nën këto deklarime shumica ka vlerësuar se qëndrimi i subjektit nuk është në përputhje me etikën e magjistratit, duke u nisur edhe nga fakti se ajo ka marrë tagrat e një gjykate, duke

¹⁰ Sipas nenit 59, “Pagesat me para në dorë”, i ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

¹¹ U konstatua blerja e një pasurie të paluajtshme, vlera e të cilës ishte likuiduar e gjitha me anë të një kredie bankare e përfituar në Raiffeisen bank, ku veprimet rezultuan të jenë kryer përmes llogarisë së noterit sikurse e parashikon ligji “Për Noterinë”

bërë individualisht një interpretim të ligjit tatimor dhe bazuar në këtë interpretim i ka kërkuar institucionit tatimor kthimin mbrapsht të tatimit të paguar.

1.46 Unë, si komisionere në pakicë, ndaj mendim ndryshe lidhur me këtë konkluzion pasi provat dhe rrethanat e konstatuara kanë treguar se subjekti, jo vetëm nuk ka qenë kontradiktor në deklaratimet e saj lidhur me këtë pagesë por, përkundër ka qenë konsistente në qëndrimin e saj se ky tatim nuk duhej paguar.

1.47 Në vlerësimin tim: (i) qëndrimi i mbajtur nga subjekti në pyetësin nr. 2, datë 26.3.2021, ku ka deklaruar se nuk ka paguar detyrimet tatimore për diferencën e çmimit të blerjes dhe të shitjes së kamionit; (ii) qëndrimi i radhës pas dërgimit të rezultateve të hetimit ku ka depozituar pagesën e detyrimit tatimor të kryer nga bashkëjetuesi i saj; (iii) qëndrimi i saj në seancë dëgjimore se nuk kishte dijeni në lidhje me datën e saktë të bërjes së pagesës; dhe (iv) vijueshmëria e qëndrimit pasues se pavarësisht pagesës së kryer nga bashkëjetuesi, në bindjen e saj, ky detyrim nuk ishte eksplicit, dhe nuk duhej paguar, provojnë faktin se subjekti ka dhënë përgjigje korrekte, duke iu referuar dijenisë dhe bindjes së saj (si dhe çdo ndodhie, sikurse ajo ka rezultuar në kohë) dhe nuk mund të konsiderohet se subjekti ka qenë kontradiktor në përgjigjet e saj dhe aq më pak të jetë përpjekur për të krijuar konfuzion apo përcjellë pasaktësi në këto përgjigje. Po ashtu, nuk pajtohem kategorikisht me qëndrimin e shumicës, e cila ka vlerësuar *se qëndrimi i subjektit nuk është në përputhje me etikën e magjistratit, duke u nisur edhe nga fakti se ajo ka marrë tagrat e një gjykate, duke bërë individualisht një interpretim të ligjit tatimor dhe bazuar në këtë interpretim i ka kërkuar institucionit tatimor kthimin mbrapsht të tatimit të paguar*, për faktin se kërkesa e bashkëjetuesit drejtuar DPT-së është një e drejtë e çdo individi për sa kohë nuk bie ndesh me ndonjë dispozitë ligjore.

1.48 Pavarësisht sa më sipër, çmoj të citoj dhe arsyetoj në mënyrë më të zgjeruar por edhe më specifike, deklaratimet e subjektit në lidhje me pagimin e tatimit ku hetimi pasqyron se:

Në pyetësin nr. 2, datë 26.3.2021, ku Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacion provues mbi pagesën e tatimit, për fitimin e realizuar nga diferenca e krijuar ndërmjet çmimit të shitjes dhe blerjes, subjekti, në datën 13.4.2021, është përgjigjur se *për këtë pasuri nuk është paguar tatimi mbi fitimin për diferencën e çmimit të shitjes dhe të blerjes*. Ky fakt konstatohet i provuar, pasi nga hetimi rezultoi se tatimi është paguar në datën 28.5.2021, pra dy muaj pas përgjigjes së pyetësit nr. 2, ku subjekti pretendon se nuk është paguar tatimi, duke u vërtetuar kështu fakti se subjekti është përgjigjur me vërtetësi se nuk e kishte paguar atë/tatimin.

1.49 Në përfundim konkludoj se qëndrimet e subjektit kanë qenë konsekuente, të njëjta, të pandryshuara dhe se kurrësi ajo nuk mund të penalizohet për faktin se i jep ligjit një interpretim të ndryshëm nga Komisioni, aq më tepër që interpretimi i saj nuk ka sjellë asnjë pasojë, për sa kohë kjo lloj pagese për këtë të ardhur ka paqartësi ligjore, sikurse do të arsyetohet në vijim, pavarësisht faktit se veprimet juridike janë kryer nga bashkëjetuesi i saj dhe se organi kompetent shtetëror konfirmon se për transaksione të tilla (shitblerje mjetesh) nuk paguhet asnjë taks apo tatim.

Në lidhje me referimet e vendimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për çështjen e pagesës së tatimit për të ardhurat e përfituara nga shitja e mjetit.

1.50 Më rezulton se shumica ka referuar vendime të Kolegjit, që në vlerësimin tim nuk gjejnë aplikim në çështjen objekt vlerësimi. Për të pasqyruar këtë konkluzion kam çmuar të evidentoj diferencat e rrethanave faktike të këtyre rasteve.

1.51 Në këtë drejtim, rezulton se në tri vendimet e cituara nga shumica¹² si standarde të jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në asnjë rast nuk konfirmojnë ngjashmëri me rrethanat konkrete në këtë çështje. Secili prej vendimeve në përfundim ka konstatuar fillimisht se detyrimi tatimor nuk ka rezultuar i paguar dhe, më tej, ka vlerësuar se *për rrjedhje, vlera e fitimit të realizuar rezulton të jetë e ardhur e paligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.*

- Në rastin në shqyrtim, duke vlerësuar mbi të gjithë faktet e rezultuara më sipër lidhur me tjetërsimin e mjetit, por duke vërejtur se në çdo lexim të bërë legjislacionit tatimor për këto të ardhura ka paqartësi, çmoj se tatimi i paguar, përmbush kërkesat e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

- Për njërin prej vendimeve nr. ***, datë 23.9.2019, të cituar nga shumica, ndaj mendim ndryshe, duke arsyetuar më në detaje se përse ky vendim nuk mund të aplikohet në çështjen objekt hetimi. Sipas këtij vendimi rezultojnë rrethanat e mëposhtme:

1. Njëri prej automjeteve është blerë nga bashkëshorti i subjektit në shumën 500.000 lekë në vitin 2003 dhe njëkohësisht është deklaruar prej tij në këtë vit (automjeti është prodhim i vitit 1993).
2. Ky automjet është shitur në vlerën 15.000 euro në vitin 2013 dhe njëkohësisht është deklaruar prej tij në deklaratën periodike të këtij viti, pra dhjetë vite më pas.
3. Në këtë rast, trupi gjykues i Kolegjit shprehet se:
 - i. çmimi i referuar në kontratën e shitjes, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk i krijojnë bindjen trupit gjykues për vlerën reale të shitjes;
 - ii. nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë paguar tatim fitimi lidhur me këtë shitje;
 - iii. subjekti i rivlerësimit me veprimet e tij ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5, e ligjit nr. 84/2016, pasi çmimi i referuar në kontratën e shitjes, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk i krijojnë bindjen trupit gjykues për vlerën reale të shitjes.

Në rastin e subjektit të rivlerësimit rezultoi se:

1. është paguar tatimi, por me vonesë;
2. ka referenca për shitje në të njëjtën vlerë për të njëjtin mjet (subjekti depozitoi disa foto me të dhëna mbi vlerën e disa automjeteve të tjera të ngjashme, kontrata shitje për të njëjtin lloj mjeti/të tonazhit të rëndë, linke të ndryshëm në internet që pasqyrojnë vlera të larta të shitjes së këtyre lloj mjeteve);
3. automjeti është shitur nga bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit brenda një kohe të shkurtër (brenda të njëjtit vit kalendarik);
4. nuk rezultoi të ishte investuar për rregullime apo mirëmbajtje të mjetit dhe kjo gjë gjithashtu nuk është pretenduar nga subjekti.

Për sa më sipër, duke qëndruar te vlerësimi i çështjes objekt hetimi, në referencë edhe të vlerësimit të Kolegjit, vërej se:

- i. nuk jemi përpara faktit se çmimi i referuar në kontratë nuk mund të jetë bindës, për sa kohë subjekti ka depozituar mjaftueshëm prova, të cilat pasqyrojnë vlerën reale të shitjes së këtij automjeti;
- ii. mjeti, është shitur thuajse në të njëjtën vlerë reale të tregut nga bashkëjetuesi i subjektit;
- iii. tatimpaguesi nuk ka munguar në shlyerjen e detyrimit, por e ka kryer atë me vonesë;

¹² nr. *** datë 2.12.2019; nr. *** datë 22.5.2019; nr. *** datë 23.9.2019

- iv. shpjegimet e subjektit kanë qenë në mënyrë konsistente se tatimi nuk duhej paguar;
- v. subjekti ka kërkuar në DRTatimore interpretimin ligjor lidhur me pagesën e tatimit mbi fitimin e krijuar në rast shitjeje të një automjeti;
- vi. subjekti ka kërkuar në DRTatimore kthimin e shumës së tatimit të paguar nga bashkëjetuesi.

1.52 Gjithashtu, vendimi nr. ***, datë 23.11.2021, nuk ngjason me rastin objekt i këtij hetimi administrativ dhe, si i tillë, as barazohet dhe as nuk duhet konsideruar, pasi në këtë vendim Kolegji ka analizuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave nga qiraja e një dyqani duke mos e njohur atë si pasojë e mospagimit të detyrimit tatimor në kohë.

1.53 Në vlerësimin tim, në ndryshim nga parashikimet në ligj¹³ se të ardhurat nga qiratë janë një e ardhur e tatueshme, të ardhurat e përfituara nga shitja e një mjeti nuk parashikohen në mënyrë eksplicite në ligj. Në të tilla kushte vlerësoj se për sa kohë ligjvënësi nuk i ka dhënë një zgjidhje të qartë detyrimit tatimor për këto të ardhura, atëherë kryerja e pagesës me vonesë nuk është në të njëjtat kushte, sikurse pagimi me vonesë i detyrimit tatimor të qirasë.

1.54 Sa i takon, referimit të vendimit nr. *** datë 18.6.2021, vlen të evidentoj faktin se edhe në këtë rast, diferenca me çështjen objekt vlerësimi është se Kolegji nuk e ka konsideruar pagesën e tatimit me vonesë të tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme, pasi ishim përpara fakteve, ku ligji e kishte të përcaktuar në mënyrë të qartë pagesën e këtij lloji detyrimi, bashkëshortja e subjektit mbante një pozicion pune, që për nga funksioni ishte njohëse e legjislacionit tatimor, duke mos e vlerësuar atë si shkak të veçuar në kriterin e pasurisë, por në tërësinë e çështjes, mbi impaktin që dhanë faktet e mësipërme.

1.55 Në çmuarjen e pakicës kam vlerësuar edhe informacionin e DPT-së¹⁴, ku thuhet se: “... në dispozitat tatimore nuk është e përcaktuar dhe/ose i listuar fitimi kapital nga shitja e pasurisë së luajtshme për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale ... ligjvënësi këto lloj transaksionesh nuk i ka parashikuar si transaksione që gjenerojnë fitim kapital neto, ku edhe në deklaratën individuale vjetore të të ardhurave (DIVA) nuk ka një rubrikë për të ardhurat e përfituara nga kalimi i të drejtës së pronësisë për pasuritë e luajtshme ... Edhe në eksperiencën e deritashme të Komisionit në çështjet e shqyrtuara nuk ka rezultuar në asnjë rast, ku kjo e ardhur të jetë njohur dhe paguar nga subjektet. Në rastin konkret vlerësoj se gjen zbatim orientimi i Kolegjit në vendimin nr. ***, për shkak se provohet bindshëm ekzistenca e shumës reale 32.000 euro nga shitja e mjetit dhe, për rrjedhojë, pagesa me vonesë e tatimit e shëron këtë të ardhur si të ligjshme. Ky argument mbështetet edhe në faktin se ky detyrim tatimor nuk është i përcaktuar qartë në ligj, sikurse e kërkon neni 155 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili sanksionon se taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj. Kjo çështje është arsyetuar në frymën e këtij neni

¹³ Sipas nenit 8 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

¹⁴ Shkresa kthim përgjigje nr. *** prot., datë 17.6.2022, e DPT citon se: “... në dispozitat tatimore nuk është e përcaktuar dhe/ose e listuar fitimi kapital nga shitja e pasurisë së luajtshme për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, sepse këto lloj pasurish janë pasuri me një kohë të caktuar përdorimi, amortizohen si dhe gjatë periudhës së përdorimit kërkojnë shërbime ciklike, bazuar në vitin e prodhimit, llojin e autoveturës, kohën e përdorur (km), pagesa e taksave, që në vetvete për individët këto konvertohen në mjete monetare shtesë të investuara drejtpërsëdrejti në jetëgjatësinë e automjetit gjatë kohës së përdorimit, deri në momentin e shitjes, ku dhe për rrjedhojë diferenca e çmimit të blerjes me çmimin e shitjes nuk përbën fitim kapital neto për individët, pasi individët për qëllime të detyrimeve tatimore si rezultat i shitjes duhet të përfshijnë edhe shumat e investuara për mirëmbajtjen, dokumentacion, taksat gjatë kohës së përdorimit të mjetit, deri në momentin e shitjes. Për arsytet më sipër, ligjvënësi këto lloj transaksionesh nuk i ka parashikuar si transaksione që gjenerojnë fitim kapital neto, ku edhe në deklaratën individuale vjetore të të ardhurave (DIVA) nuk ka një rubrikë për të ardhurat e përfituara nga kalimi i të drejtës së pronësisë për pasuritë e luajtshme. Në këtë deklaratë (DIVA) janë parashikuar vetëm fitimet kapitale të gjeneruara nga kalimi i të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, fitimet kapitale të gjeneruara nga investimet në tituj. Sa më sipër, administrata tatimore nuk ka konstatuar raste në praktikë të pagesës së tatimit mbi fitimin e realizuar nga shitja e autoveturave të përdorimit personal. Pagesa e tatimit mbi fitimin e realizuar nga shitja e autoveturave të përdorimit personal nuk është as kërkesë për ndryshimin e pronësisë së automjetit, siç është në rastin e pasurive të paluajtshme”.

kushtetues dhe është konfirmuar në vendimin nr. 18, datë 25.7.2008, të Gjykatës Kushtetuese, ku ndër të tjera thuhet se: *“Marrëdhëniet e tatim-taksave janë marrëdhënie ligjore, detyrimi ndërmjet shtetit dhe tatimpaguesve dhe, si të tilla, ato mund të përcaktohen vetëm me ligj. Megjithatë, thjesht përcaktimi i tatim-taksave si marrëdhënie detyrimi nuk është i mjaftueshëm që të passjellë automatikisht pagesën dhe mbledhjen e tyre në kohën dhe mënyrën e duhur. Është gjithashtu e nevojshme të rregullohet procedura për pagesën e tyre, e cila interalia do të përfshinte jo vetëm përmbajtjen e detyrimit, por gjithashtu çështjet organizative të administratës tatimore, metodat e llogaritjes së pagesës së tatimeve etj., pra rregullimi ligjor përfshin jo vetëm përcaktimin e tyre me ligj, por edhe procedurën e ekzekutimit të tyre”*.

1.56 Në përfundim, unë pakica, nën vlerësimin e fakteve të tilla se: (i) mosbërja e pagesës në kohë nga personi i lidhur ka ardhur si pasojë e paqartësisë ligjore dhe jo i udhëhequr nga ndonjë qëllim i paligjshëm me keqbesim; (ii) për shkak të paqartësisë ligjore personi i lidhur nuk ka pasur qëllim t'i shmanget ndonjë pagese; (iii) fakti që të ardhurat nga shitja e mjetit nuk kanë shërbyer si burim për blerjen e asnjë pasurie në të ardhmen, as nga subjekti i rivlerësimit dhe as nga personi lidhur; (iv) në rastin konkret, subjekti që ka realizuar të ardhura është personi i lidhur/bashkëjetuesi dhe jo vetë subjekti i rivlerësimit; (v) sjellja e personit të lidhur në raport me legjislacionin tatimor në fuqi në vendin tonë, i cili nuk e parashikon në mënyrë eksplicite pagimin e tatimit për të ardhurat nga shitja e mjeteve e bashkëshoqëruar kjo edhe me faktin se në tjetërsimin e pasurive të paluajtshme kushtëzimi i regjistrimit të tyre pasqyrohet në kontratën noteriale, por edhe njoftohet nga noteri, gjë që nuk ndodh me tjetërsimin e mjeteve; si dhe (vi) nën orientimin e Kolegjit në vendimin nr. 15/2021, arrij në konkluzionin se jemi përpara rrethanave që nuk passjellin penalizimin e subjektit.

Në lidhje me përdorimin e automjetit të shtetasit F.P, nga subjekti i rivlerësimit.

1.57 Kam ndarë mendim ndryshe edhe për sa i përket përdorimit të automjetit nga subjekti i rivlerësimit, marrë nga bashkëjetuesi i saj shtetasit F.P.

Në këtë këndvështrim, Komisioni ka hetuar çështjen në detaje, për të cilën shumica ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit në lidhje me mosdeklarimin e përdorimit të automjetit në fjalë është në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të paplotë të pasurisë në përdorim, në kundërshtim me sa parashikohet në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

Në këtë çështje objekt vlerësimi, ndryshe nga shumica, kam vlerësuar nën konstatimet se: (i) nga hetimi nuk rezultuan lëvizje të subjektit të rivlerësimit në sistemin *TIMS*; (ii) nuk pati një referencë për të provuar shpeshësinë e përdorimit të automjetit, përveçse nga dokumentacioni i AMF-së (sipas policës së sigurimit e cila domosdoshmërisht aplikohet dhe përfitohet në periudhë njëvjeçare); (iii) subjekti e ka deklaruar përdorimin e automjetit që në pyetësonin standard; (iv) nuk u konkludua mbi dyshime për pasuri të fshehur, pasi u provua burimi i ligjshëm i krijimit të pasurisë së përdorur nga subjekti dhe, për pasojë, në pikëpamjen time kjo pasaktësi në vetvete nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkakut penalizues për subjektin e rivlerësimit.

1.58 Kam arritur në këtë konkluzion duke respektuar edhe standardin tim si relatore, në vendimin nr.***, datë 27.7.2020, të Komisionit, të formës së prerë, i cili ka trajtuar të njëjtën çështje në rrethana krejtësisht identike.

2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës

2.1 Unë, si komisionere në pakicë, ndaj mendim ndryshe sa i përket kontrollit të këtij kriteri. Nga hetimi i thelluar administrativ i kryer për këtë kriter, Komisioni, pas njohjes me gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar i kaloi subjektit barrën e provës¹⁵ për të provuar të kundërtën e rezultatit, pasi dukej se: (i) personi i lidhur/bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit ka pasur kontakt të papërshtatshëm me shtetasin L.L, në shkelje të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk kishte përmbushur detyrimin ligjor për të deklaruar kontaktin e papërshtatshëm të personit të lidhur/bashkëjetuesit të saj, me shtetasin L.L, përcaktuar në deklaratën për kontrollin e figurës, në gerrat “d” dhe “f”, në pjesën 5, titulluar “Të dhëna për sigurinë”, për shkak të hyrjes në marrëdhënie kontraktore shitblerjeje dhe huadhënie/interesa pasurore, të bashkëjetuesit me këtë shtetas¹⁶.

2.2 Në këto kushte, në vlerësimin tim, fillimisht, duhet arsyetuar dhe konkluduar lidhur me këto konstatime për të qartësuar më tej mbi konstatimin e shumicës për gjendjen e cenimit të besimit të publikut për subjektin e rivlerësimit.

2.3 Në këto rrethana, në analizë të fakteve të pasqyruara në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar, dokumentacionit të depozituar, i përfutur në rrugë institucionale përmes Ministrisë së Drejtësisë Shqiptare, shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, si edhe dokumenteve të depozituara nga subjekti me prapësimet e saj, arsyetoj si vijon:

Në kushtet kur provohej: (i) gjendja gjyqësore e shtetasit L.L, si i dënuar me vendim të formës së prerë, si pasojë e një vendimi të marrë nga një gjykatë në shtetin italian, për një vepër penale e cila përfshihet në ato vepra që parashikon neni 3/15 i ligjit nr. 84/2016; (ii) marrëdhënia civile e shkëmbimit të parave të personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, me një person të përfshirë në krimin e organizuar, si pasojë e një shitblerjeje pasurie, në kuptim të nenit 38/4/c të po këtij ligji, ajo që mbetet për t’u provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, ishte fakti i pasjes dijeni të personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, i cili kishte hyrë në marrëdhënie me një shtetas të dënuar për një vepër penale të përfshirë në krimin e organizuar dhe që, për pasojë, konkluzioni do të mund të ndikonte në vërtetësinë e kontaktit të papërshtatshëm, si dhe në vërtetësinë e deklarimeve të subjektit në deklaratën e kontrollit të figurës.

2.4 Në këtë kontekst, analiza për këtë çështje u vlerësua në harmoni me të gjitha verifikimet e mundshme.

2.5 Në nivel provueshmërie u vërejt se dëshmia e gjendjes gjyqësore, e përcjellë nga institucioni përgjegjës Ministria e Drejtësisë Shqiptare për shtetasin L.L, identifikonte këtë të fundit të padënuar për veprën penale të kryer në shtetin italian, ku dhe ishte dënuar me vendim të formës së prerë, fakt ky që nënkuptonte qartazi se vendimi i shtetit të huaj nuk i ishte bërë me dije autoriteteve shqiptare dhe, për pasojë, ai nuk ishte regjistruar në regjistrin e posaçëm sikurse e parasheh neni 29/1¹⁷ i ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”.

2.6 Këtë fakt e konfirmoi Ministria e Drejtësisë¹⁸, ku nëpërmjet informacionit të dhënë informonte se *nuk ka asnjë vendim penal të huaj të njohur nga autoritetet shqiptare në lidhje me shtetasin L.L.*

2.7 Në një sferë më të gjerë hetimi, Komisioni aksesoi edhe median e shkruar dhe atë vizive, nga ku nuk u provua në asnjë rast në formë direkte ose indirekte ndonjë e dhënë që të

¹⁵ bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

¹⁶ referuar nenit 38/4/c të ligjit nr.84/2018.

¹⁷Neni 29 Regjistri gjyqësor penal i shtetasve shqiptarë të dënuar jashtë shtetit 1. Zyra e Regjistrat Gjyqësor regjistron në një regjistër të posaçëm shkurtimet e vendimeve për shtetasit shqiptarë të dënuar penalisht jashtë shtetit, duke përfshirë edhe shtetasit shqiptarë të lindur jashtë shtetit. Për këtë qëllim krijohet një regjistër i posaçëm pranë kësaj zyre.

¹⁸Shkresë nr. *** prot., datë 29.4.2022.

identifikonte këtë shtetas si të dyshuar apo të dënuar për veprën penale “trafikim të lëndëve narkotike”.

2.8 Po ashtu, edhe nga aksesit në sistemin *TIMS* rezultoi se shtetasi L.L nuk kishte munguar në hyrje-dalje jashtë vendit, ndërsa nuk rezultonte i ndaluar apo nuk u provua që vendimi i dhënë ndaj tij në shtetin italian të ishte ekzekutuar.

2.9 Këto rrethana të analizuara së bashku duket se shkojnë në favor të subjektit dhe, për pasojë, përjashtojnë tërësisht analizimin dhe konsiderimin e rrethanave lehtësuese apo rënduese për sa kohë në asnjë moment nuk u mësua elementi bazë, të qenurit në kushtet e dijenisë së bashkëjetuesit të subjektit për përfshirje të shtetasit L në kryerjen e një veprë penale që përfshihet në krimin e organizuar dhe, për pasojë, përjashtohet kontakti me të në kushtet e papërshtatshmërisë përgjatë kryerjes së marrëdhënieve civile të shitblerjes dhe huadhënieve e anasjelltas, dhe që për rrjedhojë konkludohet se subjekti ka plotësuar me vërtetësi e saktësi deklaratën për kontrollin e figurës.

2.10 Në një këndvështrim tjetër: (i) duke ndjekur deklaratimet e subjektit, i cili ka sqaruar njohjen e bashkëjetuesit të saj me shtetasin L, prej kohës së fëmijërisë për shkak se ishin rritur në të njëjtën zonë, për të cilin ka bërë prezent edhe faktin e largimit të këtij shtetasi nga vendlindja shumë herët; (ii) për faktin se subjekti ka sqaruar që bashkëjetuesit të saj në marrëdhënien civile të krijuar nuk i është bërë me dije nga shtetasi L dënimi në shtetin italian, deklaratim të cilin ky i fundit e pasqyron në deklaratën noteriale të depozituar nga subjekti; si edhe (iii) në konsideratë edhe të pretendimit të subjektit mbi hasjen e vështirësive ligjore për të mësuar mbi gjendjen gjyqësore reale të një personi, çmoj se në çdo rast këto qëndrime do të bëheshin të cenueshme proporcionalisht në vlerësimin e këtij kriteri, nëse do të gjendeshim përpara qoftë edhe njërit prej përmbushjes së elementëve, si njohja me të dhëna bashkëshoqërimi me shtetasin L, nga sistemi *TIMS*, njohja me të dhëna mbi dënueshmërinë nga aksesit në media, apo njohja dhe regjistrimi i vendimit të huaj në autoritetet shqiptare.

2.11 Të gjitha provat treguan se dijenia e vetme që u mësua mbi këtë veprë penale të kryer nga shtetasi L.L ishte gjetja e përcjellë përgjatë hetimit administrativ, që padyshim, është ekzistenciale, por e parrethuar me kriteret dhe karakteristikat që kërkon legjislacioni i parashikuar në kreun përkatës të kontrollit të këtij kriteri, në ligjin nr. 84/2016.

2.12 Për pasojë, nën këtë nivel provash, rrethanat e konstatuara përjashtojnë subjektin nga përgjegjësia për të deklaruar faktin e përcjellë me gjetjen e vëzhguesit, për sa kohë u provua mosdijenia/mosnjohja me vendimin penal edhe nga institucionet ligjzbatuese.

- ✓ Mbi këto fakte, për sa kohë nuk u provua e kundërta konkludohet se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi deklaratën për kontrollin e figurës.
- ✓ Nën këtë arsyetim arrij në konkluzionin se nuk u provuan kushte apo rrethana, të cilat në kuptim të kreut V të ligjit nr. 84/2016 apo specifikisht të nenit 38 të po këtij ligji, e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

2.13 Këto konstatime të ndërthurura me të gjitha veprimet e kryera mes bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit L, të cilat rezultuan sipas legjislacionit, por gjithashtu të ndërthurura edhe me faktin se çështja penale për të cilën është dënuar ky shtetas, nga dëshmia e gjendjes gjyqësore të shtetit italian konfirmohej e kryer në vitin 2004, kohë në të cilën subjekti i rivlerësimit nuk ekziston në lidhje me bashkëjetuesin e saj, pasi kjo marrëdhënie konfirmohet prej vitit 2013, bëjnë të besueshme deklaratimet e subjektit se dijenia për dënimin e shtetasit L.L nuk ka qenë e mundur të mësohej.

2.14 Në raste të tjera të ngjashme në standardin e Komisionit nuk është prezumuar dijenia as edhe për pjesëtar të familjes, përveçse kur rrethanat konkrete kanë arritur të bëjnë të besueshme dijeninë.

2.15 Nuk jam dakordësuar me shumicën kur shprehet se *Komisioni konstaton gjendjen e cenimit të besimit të publikut për subjektin e rivlerësimit duke marrë në konsideratë faktin e ndërthurjes së interesave personal të saj dhe bashkëjetuesit të saj me një person të dënuar për vepra që përfshihen në krimin e organizuar.*

2.16 Si pakicë vlerësoj se nuk qëndron ky konstatim pasi kontratat e lidhura midis bashkëjetuesit të saj dhe shtetasit L.L janë lidhur në padijeni të plotë rreth dënimit të këtij shtetasi në një shtet të huaj dhe se duhet mbajtur në konsideratë fakti që subjekti dhe bashkëjetuesi i saj janë në bashkëjetesë, ku referuar deklaratave të pasurisë së subjektit nuk rezultoi që ajo të ketë përfituar ndonjë interes pasuror të drejtpërdrejtë nga kontratat e lidhura nga bashkëjetuesi i saj me këtë shtetas. Nga shumica nuk duhet të ishte prezumuar përfitimi pasuror i subjektit, për sa kohë subjekti nuk ka asnjë interes pasuror nga këto veprime në kuptimin e vlerësimit të figurës së subjektit në raport me kontaktin e bashkëjetuesit të saj me shtetasin L.L.

2.17 Në të tilla kushte, këndvështrimi i gjetjes për të konkluduar në drejtim të konstatimit të cenueshmërisë së besimit të publikut ndaj subjektit të rivlerësimit nuk mund të merret i mirëqenë për sa kohë provat dhe rrethanat e kësaj çështjeje nuk evidentuan asnjë *indicie* që ngarkon me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit.

3. Në lidhje me çështjen e përshkruar te rubrika “Gjetje të tjera”, ku pasqyrohet një situatë konfliktuale e ndodhur midis disa shtetasve dhe ku, ndër të tjera, është përmendur edhe emri i bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit, informacion ky i marrë nga aksesit në media, unë si mendim pakicë për shkak të informacionit të grumbulluar, shpjegime të dhëna nga subjekti apo edhe dokumentacionit të depozituar prej saj, bashkohem me arsyetimin e shumicës, por duke shtuar faktin se në gjendjen që ndodhen aktet më është krijuar bindja se kjo çështje e pavërtetuar deri aktualisht për autorësinë e kryerjes së veprës penale, nuk mund të ngrihet në nivelin e implikimeve të bashkëjetuesit të subjektit në një situatë të pretenduar por e pa pazbardhur dhe për pasojë as edhe nuk mund të ndikojë në vlerësimin e ndonjë kriteri matës në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit. Për pasojë nuk dakordësohem me shumicën kur shprehet se vlerëson përforsimin e marrëdhënies shoqërore të bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit me shtetasin L.L për faktin se ai/bashkëjetuesi është përmendur në këtë procedim penal ku palë në konflikt ka qenë shtetasi L dhe një shtetas tjetër”. Pra, shumica i jep peshë termit “përmendur”, ndërkohe që nga aktet e dosjes nuk rezultoi asnjë e dhënë që implikonte bashkëjetuesin e subjektit në këtë çështje.

4. Në lidhje me videot e publikuara në rrjetin social “Tik Tok”

4.1 Në lidhje me këtë çështje kam ndarë mendim ndryshe me konkluzionin e shumicës e cila ka konkluduar gjendjen e cenimit të besimit të publikut për subjektin e rivlerësimit, në lidhje me kryerjen e videove në ambientet e punës shoqëruar këto video me lëvizje dhe sjellje provokuese të shoqëruar në sfond me muzikë të natyrës jo të hijshme dhe të papërshtatshme për imazhin e një magjistrati, duke mbajtur në konsideratë disa faktorë të rëndësishëm:

i. Ndodhinë e faktit përgjatë kohës së ngritjes dhe funksionimit të organit kompetent ILD-së dhe KLGJ-së, e cila ka të formësuar të gjithë kompetencën lidhur me vlerësimin e çështjeve etiko-profesionale të një subjekti rivlerësimi (në kuptim të ligjit nr. 84/2016).

ii. Procedurën e ndjekur (dhe e administruar nga Komisioni) nga ILD-ja dhe KLGJ-ja lidhur me këtë çështje.

iii. Marrëveshjen e nënshkruar midis subjektit të rivlerësimit dhe ILD-së me vullnet të palëve sikurse e ka parashikuar legjislacioni i fushës.

iv. Vendimin përfundimtar të paankimueshëm të KLGJ-së lidhur me këtë çështje, duke pezulluar subjektin nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit për një periudhë 6-mujore dhe trajtimin e saj me pagë minimale përgjatë kësaj kohe.

4.2 Në të tilla kushte, për sa kohë kjo çështje është gjë e gjykuar, vlerësoj se subjekti nuk mund të ndëshkohet dy herë pra në mënyrë të përsëritur. Nuk perceptoj që në vlerësim të nivelit profesional dhe marrjes së një mase e cila ka përmbushur qëllimin e plotë të ndëshkueshmërisë të mund të etiketohet subjekti në këndvështrim të cenimit të besimit të publikut për sa kohë ky moment është shteruar gjithashtu nga vendimi i dhënies së masës ndaj subjektit.

4.3 Në raport me pretendimin e subjektit për gjë të gjykuar shumica shprehet se: *“Procesi i rivlerësimit rregullohet nga ligji nr.84/2016 dhe që është një proces i pavarur që nuk lidhet me veprimtarinë e organeve të tjera, për rrjedhojë koncepti i gjësë së gjykuar nuk mund të gjej aplikim në rastin në fjalë”*.

4.4 Si komisionere në pakicë, vlerësoj se gjatë procesit të rivlerësimit nuk përbëjnë gjë të gjykuar për Komisionin raportet e hartuara më parë nga institucionet ndihmëse si ILDKPKI-ja, KLGJ-ja dhe DSIK-ja, në kuptimin që Komisioni bën hetimin e tij të pavarur për çështjet që janë në kompetencë të tij në raport me shtrirjen kohore që përcakton ligji.

4.5 Bazuar në dispozitat ligjore të ligjit nr.84/2016 raportet e hartuara nga organet ndihmëse nuk janë detyruese dhe çështjet e trajtuara prej tyre nuk përbëjnë gjë të gjykuar për Komisionin, por në rastin konkret çështja e procedimit disiplinor të saj e iniciuar në vitin 2021 nuk është pjesë e raportit të KLGJ-së, për subjektin e rivlerësimit, pikërisht për faktin se nuk është brenda periudhës së vlerësimit të sanksionuar shprehimisht në ligjin nr.84/2016. Në vlerësimin tim, kjo çështje i referohet gjithashtu, parimit të “ndarjes dhe balancimit të pushteteve”¹⁹ si pjesë e procesit të rregullt ligjor.

4.6 Në vlerësimin tim si pakicë, çmoj se një vlerësim ndryshe i Komisionit dublon/mbivendos kompetencat edhe në kushtet kur kjo çështje përgjatë hetimit administrativ u ezaurua me vendim të formë së prerë nga institucionet kompetente.

4.7 Nuk ndaj të njëjtin mendim me shumicën ndërsa shprehet se arsyeja pse subjekti ka arritur marrëveshje me KLGJ-në është që të shmangte ndonjë pasojë më të rëndë ndaj këtij procedimi, pasi për mendimin tim ndjekja e kësaj procedure është e parashikuar në ligjin nr. 96/2016, sikurse dhe është proceduar. Kam ndarë mendim ndryshe për këtë çështje duke u bazuar, gjithashtu, në qëndrimin e mbajtur nga Komisioni ku kam qenë pjesë e trupës gjykuese, në vendimin nr. ***, datë 30.4.2021, për subjektin e rivlerësimit E.S ku, ndër të tjera, argumentohet se: *“Subjekti, në prapësimet e datës 21.4.2021, nuk depozitoi asnjë dokument provues mbi gjendjen shëndetësore, për të justifikuar pamundësinë objektive për të udhëtuar nga SHBA-ja, pas përfundimit të lejes 2-vjeçare të dhënë nga KLD-ja. Trupi gjykues, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti nuk është paraqitur për të ushtruar detyrën e gjyqtarës pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, që nga data 1.4.2020, si dhe nisur nga parashikimi ligjor për sa i përket periudhës së rivlerësimit, vlerëson se shkelja disiplinore lidhur me etikën, e ndodhur pas kësaj periudhe është kompetencë vlerësimi e KLGJ-së”*.

4.8 Sa më sipër, si Komisionere në pakicë vlerësoj se, për sa kohë procedimi disiplinor ndaj subjektit ka përfunduar me vendim²⁰ të formës së prerë nga organi kompetent, për rrjedhojë

¹⁹ Referuar edhe vendimit nr.11, datë datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese, ndër të tjera theksohet se: ... *“Çdo institucion i secilit pushtet gëzon kompetencën sipas këtij qëllimi. Përmbajtja konkrete e kësaj kompetence varet nga fakti se cilit pushtet i përket institucioni, nga vendi i tij midis institucioneve të tjera, nga raportet e tij me ato të institucioneve të pushtetit shtetëror. Në përputhje me detyrat që u ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm, gjë që i jep mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese.”*

²⁰ nr.6, dt 17.01.2022 të KLGJ-së

kemi të bëjmë me një gjë të gjykuar dhe që për pasojë nuk mund të ndëshkohet subjekti në mënyrë të përsëritur.

5. Në lidhje me denoncimet e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar, si më poshtë vijon:

5.1 Më tej në mendimin tim si pakicë kam ndarë mendim ndryshe nga shumica për katër denoncime për të cilët shumica nuk ka analizuar tërësinë e tyre, pra nuk ka analizuar mbi pretendimet e denoncuesve, pretendimet e subjektit të rivlerësimit, provat e administruara, mbi rolin dhe punën e subjektit, por është mjaftuar me deklaratat noteriale të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të lëshuara nga denoncuesit të cilët kanë shprehur në to vullnetin e tyre të lirë se nuk kanë qenë ata të cilët kanë bërë denoncimet, duke qartësuar rast pas rasti edhe funksionin e tyre në raport me pretendimet e pasqyruara në denoncime, por edhe duke shprehur gatishmërinë për të dëshmuar përpara trupit gjykues nëse shihej e nevojshme.

5.2 Në këtë drejtim konstatoj se në tri rastet për të cilat është paraqitur deklaratë noteriale e denoncuesve, kam vlerësuar që denoncimet të identifikohen në vijim në mënyrë të plotë, duke përshkruar pretendimet e denoncuesve, gjetjet e Komisionit, pretendimet e subjektit të rivlerësimit, provat e administruara prej Komisionit si dhe vlerësimin tim si pakicë, për tu kuptuar më qartë se çfarë roli luajnë në të vërtetë deklaratat noteriale në raport me rolin dhe punën e subjektit të rivlerësimit, por edhe për faktin se shumica ka konkluduar edhe mbi zgjidhjen e çështjeve të përshkruara në këto denoncime. Ndërsa në lidhje me denoncimin e katërt²¹ i cili është trajtuar vetëm në konceptin e deklaratës noteriale, mendimi im reflektohet në arsyetimin si vijon, mbi peshën që merr ky akt në tërësi në këto denoncime.

5.3 Kam ndarë qëndrim ndryshe lidhur me konsiderimin e këtyre deklaratave noteriale nga shumica duke evidentuar pikërisht faktin që pas depozitimit të deklaratave noteriale nga subjekti, denoncuesi²² Q.L në denoncimin vijues të tij ndër rreshta vërehet se ai ka parashtruar mbi situata apriori ose të ditura, të cilat në vlerësimin tim kanë paragjykuar krejtësisht këtë çështje. Më konkretisht, denoncuesi është shprehur: *Deklaratat noteriale (që heq dorë nga denoncimi i tyre në KPK) duhet të quhen lëvizje e provokuar për shkak të këtij procesi, sepse palët kanë hequr dorë sipas kërkesës së subjektit dhe jo me vullnetin e tyre të lirë aq më tepër që palët janë kontaktuar nga subjekti për të ndikuar në vullnetin e tyre. Këto veprime të subjektit nuk janë korrekte, nuk janë sipas nenit 53 të Ligjit nr.84/2016 dhe nuk ka vlerë heqja dorë e palëve me kërkesë të subjektit sepse përbën shkelje të rregullave etike për sjellje e subjektit me palët ankuese...*

5.4 Në perceptimin tim i njëjti denoncues ka lëshuar një deklaratë noteriale dhe nga ana tjetër kryen një veprim pasues i cili të dikton argument dhe bindje se kemi të bëjmë me një situatë faktike, e cila nuk pasqyron vërtetësinë në raport me çfarë është konkluduar nga trajtimi i secilës çështje të denoncuar dhe gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, që është bërë pjesë përbërëse e këtij procesi të gjerë hetimor.

5.5 Në drejtim të vlerësimit të shumicës se deklaratat noteriale/ky veprim nuk përputhet me etikën e magjistratit, pasi së pari ajo nuk mund të ketë kontakt me person që ka gjykuar, dhe së dyti nuk mund të kontaktojë persona të cilët kanë paraqitur një denoncim pranë organeve të rivlerësimit dhe se në lidhje me pretendimin e subjektit në seancë, se këto persona janë kontaktuar nga ana e avokatit ai mbetet në nivel deklarativ, pasi në asnjë nga deklaratat noteriale nuk citohet ky fakt, ndaj mendim ndryshe duke arsyetuar si vijon:

²¹ nr.*** prot, datë 15.12.2021 i shtetasit D.Ç

²² në denoncimin e depozituar me e-mail në datë 27.01.2022

i. Së pari deklarata noteriale është një akt i njëanshëm i dhënë nga një ose disa persona në prezencë të noterit publik, nën vullnet të lirë, të plotë dhe krejtësisht të padiktuar përsa kohë e kundërta nuk provohet.

ii. Duke iu referuar përmbajtjeve të tyre konstatohet gatishmëria e deklaruesve për të dëshmuar edhe përpara trupit gjykues lidhur me faktin se nuk kanë qenë ata të cilët kanë bërë denoncimet në adresë të subjektit të rivlerësimit.

iii. Nga ana tjetër subjekti i rivlerësimit përgjatë hetimit dhe zhvillimit të seancave dëgjimore i ka kërkuar trupit gjykues të thërrasë këta shtetas me cilësinë e dëshmitarit, për të cilët trupi gjykues ka vendosur mos pranimin e kërkesës, duke u mjaftuar me deklaratat.

iv. Shumica pretendon se mbeti në nivel deklarativ pretendimi i subjektit që këto deklarata janë marrë nga avokatja e subjektit dhe jo vet subjekti, pasi ky fakt nuk citohet në deklaratë.

5.6 Vlerësoj se ky interpretim i shumicës nuk është i bazuar pasi në deklaratat e lëshuara²³ nga denoncuesit e pretenduar, në asnjë prej tyre nuk citohet që i janë dhënë drejtpërdrejtë subjektit. Lëshimi i një deklarate të tillë nuk vërteton kush e ka kërkuar lëshimin e saj, dhe as kush është prezent gjatë bërjes së deklarimeve tek noteri. Këto deklarata nuk provojnë që ka qenë subjekti ajo që i ka kërkuar dhe as faktin që subjekti ka qenë prezent tek noteri gjatë hartimit të tyre. Gjithashtu në këtë çështje duhet të evidentohet fakti se subjekti në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar verifikimin e autorësisë së denoncimeve, ka kërkuar të bëhet ekspertim i IP, emaileve denoncuese për të identifikuar se nga janë nisur denoncimet, për shkak se ka pretenduar se ndaj saj bëheshin sulme personale nga një gjyqtar i Gjykatës Elbasan dhe nga Prokuroria Elbasan. Në këtë drejtim, pavarësisht faktit se gjatë procesit ka rezultuar se disa denoncues në përmbajtje të denoncimeve nuk kanë referuar shkelje konkrete për subjektin, por kanë parashtruar²⁴ analizë të fakteve dhe provave për një vendimarrje shkarkimi, çëshjen në fjalë e vlerësoj e udhëhequr nga parimi i objektivitetit, bazuar në ligj dhe në prova.

a. Denoncim²⁵ i shtetasit Q.L (Q.L)

Për çështjen me denoncues Q.L (për të cilën subjekti ka depozituar Deklaratën noteriale nr.*** datë 15.01.2022) Komisioni ka hetuar në drejtim të konfliktit të interesit lidhur me çështjen me të pandehur S.S, etj, me viktimë djalit e denoncuesit shtetasin F.SH. Gjatë hetimit subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale ku denoncuesi mohon të ketë qenë ai autor i denoncimit kundër subjektit.

Pas hetimit të kryer nga Komisioni lidhur me konfliktin e interesit shumica konkludon sërish me të njëjtin vlerësim si në pikën nr.5.5 për të cilën nuk çmoj të bie në përsëritje por evidentoj faktin që Komisioni e hetoi këtë çështje për trajtimin e konfliktit të interesit, nga ku çmoj të argumentoj se:

Nga studimi në tërësi i të gjitha provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në raport me ligjin për konfliktin e interesit konkludoj se subjekti nuk ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit për arsyet si vijon:

- provohet që në kohën e gjykimit subjekti nuk ka qenë në marrëdhënie pune me Universitetin Aleksandër Xhuvani Elbasan;
- palë në gjykim nuk ka qenë shtetësja I.S (***);

²³ Sipas ligjit “Për Noterinë”

²⁴ si në denoncimin e depozituar me e-mail në datë 27.01.2022

²⁵ Ardhur me e-mail në datë 28.09.2020

- nuk është asnjë nga rastet për të cilën subjekti duhet të kishte hequr dorë nga gjykimi, pasi nuk plotësohen kërkesat e asnjë prej rasteve të parashikuara në nenet 15, 16 dhe 17 të K.Pr.Penale;
- në seancën e sigurimit të provës nuk disponohet me vendim nga trupi gjykues por vetëm administrohet procesverbali i seancës dhe i vihet në dispozicion organit procedues;
- nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e subjektit nga gjykimi i çështjes,

Në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe provave të depozituara, kam vlerësuar se të dhënat shkojnë në favor të subjektit jo vetëm përse kohë nuk u provua e kundërta, por duke u ndërthurur kjo edhe me objektin për të cilin gjykata ka vendosur sigurimin e një prove të rëndësishme për të provuar autorësinë e çështjes penale, që në këtë rast dyshohej të ishte pikërisht shtetasi për të cilin denoncuesi pretendonte se po favorizohej nga subjekti për shkak të ushtrimit të mësimdhënies prej saj, në të njëjtin fakultet me familjarë të këtij të pandehuri. Të gjithë provat e depozituara duket se nuk identifikuan asnjë rrethanë të çdo lloj konflikti interesi dhe për pasojë i kanë mundur subjektit të ishte në kushtet e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë për shkak të nevojës së zbardhjes së çështjes. Në këtë rast gjykata ka lejuar organin e prokurorisë të administrojë një provë thelbësore për të provuar akuzën në ngarkim të të pandehurve, e cila prezumohet se është në interes të akuzës dhe të viktimës. Në këto kushte nuk kam vërejtur ndonjë problematikë as edhe në drejtim të afateve të gjyqimit pasi çështje është përfunduar për 17 ditë nga marrja e saj për gjykim nga subjekti i rivlerësimit dhe për pasojë nuk kam identifikuar problematika që të mund të ndikonin në vlerësimin profesional të subjektit dhe as në ndonjë prej komponentëve specifik

- Në përfundim nga gjithë rrethanat e mësipërme çmoj se subjekti nuk ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit.

b. Denoncim²⁶ i shtetasit B.K (B.K)

Denoncuesi në ankimin e tij pretendon për vendimarrje të padrejta dhënë nga subjekti i rivlerësimit, si dhe për bashkëpunim të kësaj të fundit me avokaten B.B, e cila sipas tij ndikon në proceset gjyqësore. Denoncuesi adreson si problematik vendimin e datës 30.04.2020, dhënë gjatë kohës së karantinimit total në fillim të pandemisë, mbi pushimin e procedimit penal nr.*** i vitit 2013 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për të pandehurit M.L ose i njohur ndryshe S.Ç dhe E.Ç, të cilët në atë kohë ishin në kërkim, pasi gjykata kishte vendosur masën e arrestit me burg ndaj tyre. Denoncuesi ndër të tjera ankohet se i) përse ky vendim u dha pikërisht në kohën e karantinimit total për shkak të pandemisë.

- Komisioni, ka hetuar në lidhje me pretendimin e këtij denoncuesi për vendimarrjen e dhënë nga subjekti (gjatë kohës së karantinimit të plotë), në çështjen penale me të dyshuar M.L dhe E.Ç, që lidhet me procedimin penal nr.*** të vitit 2013 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe për këtë administroi kopje të praktikës gjyqësore²⁷, nga analizimi i së cilës rezultoi se denoncuesi ka lidhje (në cilësinë e viktimës) me këtë procedim penal, madje duket se raporti i tij me këtë procedim është disi i ndërlikuar. Por njëkohësisht lidhur me vijimësinë e kësaj çështje edhe në Gjykatën e Lartë, është ankuar një tjetër denoncues²⁸ i cili pretendon për zbatim të gabuar të ligjit nga subjekti në vendimarrjen e saj, fakt ky (shprehet denoncuesi) i konstatuar nga kjo gjykatë. Denoncuesi ka depozituar vendimin e Gjykatës së Lartë nr.***, datë 08.03.2022. Në verifikimin tërësor të çështjes rezultoi si vijon:

²⁶ Nr. ***prot, datë 17.11.2021

²⁷ Dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me shkresën nr. *** prot, datë 24.11.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁸ Shtetasi T.B ka depozituar denoncimin e tij në mënyrë elektronike në datë 3.05.2022.

i) Çështja penale është vënë në lëvizje nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjykim, ndaj të pandehurit M.L dhe E.Ç, të akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 110/2 dhe 278 të Kodit Penal.

ii) Fillimisht kjo çështje është marrë për gjykim nga një tjetër subjekt rivlerësimi i cili bazuar në nenin 17/2 të K.Pr.Penale, ka kërkuar me kërkesën “Për heqje dorë nga gjykimi”, datë 11.03.2020, zëvendësimin e tij, pasi më parë kishte vendosur revokimin e vendimit të pushimit të procedimit penal datë 16.12.2013 dhe rifillimin e tij/procedimit.

iii) Mbi këtë argumentim zv/kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin e datës 2.04.2020 ka pranuar kërkesën për heqje dorë nga gjykimi i çështjes penale nr.*** Akti, datë 14.02.2020 dhe kalimin e çështjes për short.

iv) Ndryshimi i gjyqtarit të çështjes, konkretisht zëvendësimi i gjykimit të saj, me subjektin e rivlerësimit është bërë me shortin elektronik të datës 2.04.2020, ora 9:40:03.

v) Subjekti i rivlerësimit me vendimin e saj nr.***, datë 30.04.2020, për këtë çështje me objekt: Dërgimin e çështjes (për gjykim) penale nr.***, të vitit 2013, në ngarkim të pandehurit L akuzuar për veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve të zjarrit”, parashikuar nga neni 278/2 i K.penal (sipas ligjit të kohës) dhe “Heqjes së paligjshme të lirisë” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 110/2 i K.penal, ..., ka vendosur Pushimin e çështjes dhe shuarjen e masës së sigurimit “Arrest me burg” për të pandehurin M.L dhënë me vendimin nr.***, datë 11.06.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

vi) Më tej, mbi ankimin e organit të akuzës, gjykata e Apelit Durrës me vendimin e saj nr.***, datë 23.09.2020 ka vendosur, lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

vii) Në analizë të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, pa zëvendësuar logjikën e subjektit në arsyetimin e tij, vërehet se prokuroria ka kërkuar dërgimin në gjyq të kësaj çështje penale, ndërsa të pandehurit, mbrojtur me avokatët përkatës si dhe viktimia dhe mbrojtësi i këtij të fundit kanë kërkuar pushimin e çështjes. Në arsyetim thuhet se viktimia K i qëlluar në këmbë pas një konflikti të ndodhur në automjet, ka dhënë deklarime kontradiktore, pra një herë ka identifikuar autorin e ngjarjes, konkretisht shtetasit L dhe Ç, ndërsa i pyetur më pas ka mohuar ti ketë njohur ata. Në këto kushte është bërë ndarja e procedimit penal duke vijuar me procedimin nr.*** në ngarkim të shtetasit B.K akuzuar për veprën penale të “Deklarimit të rremë përpara prokurorit” dhe në procedimin penal nr.*** të vitit 2013, për veprat penale të parashikuara nga nenet 89-25 dhe 278/2 të K.Penal. Pas ndarjes, procedimi penal në ngarkim të shtetasit K ka kaluar për gjykim, ndërsa procedimi tjetër nr.*** është pezulluar në vitin 2014 për moszbulim të autorëve dhe ka kaluar për hetime të mëtejshme në Komisariatit e Policisë Elbasan, ndërsa në dt 26.12.2013 është pushuar (nga subjekte te tjere rivleresimi) procedimi penal për akuzat në ngarkim të personit nën hetim M.L, pasi nuk provohej që veprat penale ishin kryer prej tij, vendim ky i formës së prerë i pa u ankimuar. Në muajin korrik të vitit 2018 është dërguar një informacion nga DPPShtetit (Njësia speciale Task Force) në lidhje me rifillimin e hetimeve të procedimit penal nr.***. Pas kryerjes së disa veprimeve hetimore organi i akuzës ka kërkuar në gjykatë revokimin e vendimit të pushimit datë 23.12.2013 në ngarkim të shtetasit M.L, kërkesë e cila është pranuar me vendimin e gjykatës nr. ***, datë 14.12.2018, duke u vendosur vazhdimi i hetimeve. Sa i përket veprës penale të plagosjes së lehtë me dashje të shtetasit B.K, është bërë pushimi i pjesshëm i çështjes pasi vepra është parashkruar bazuar në nenin 66 të K.Penal, duke qenë se kishin kaluar mbi pesë vjet nga dita e ndodhisë së ngjarjes. Më tej, thuhet në vendimin e subjektit, se nga ana e prokurorisë është urdhëruar regjistrimi i veprave penale të “Korrupsionit aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike” në bashkëpunim dhe “Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”, pasi gjatë përgjimeve të kryera ka rezultuar se shtetasi K së bashku me të tjerë dhe me persona që

ushtrojnë funksione publike pranë institucionit të AMA-s, favorizoheshin dhe favorizonin kundrejt pagesave të ndryshme në *para* me qëllim transmetimin e paligjshëm të sinjalit televiziv dhe se ky procedim penal është ndarë edhe në procedimin penal nr.***, përse i përket këtyre veprave penale me qëllim shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve në prokurorinë speciale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (SPAK). Subjekti ka arsyetuar se organi i akuzës në çështjen L i është referuar thujse të njëjtave prova që ka pasur në kohën e pushimit të procedimit në ngarkim të këtij shtetasi, vendim i cili ka ezauruar akuzat e ngritura, si dhe ka pasqyruar faktin se shtetasi K i dënua më parë për deklarim të rremë, edhe në rifillimin e hetimeve por edhe seancën gjyqësore të dërgimit të çështjes në gjyq ka pohuar se i qëndron deklarimeve se nuk është i pandehuri L që i ka gjuajtur me armë dhe as E. Ç që drejtonte makinën. Subjekti ka arsyetuar disa vendime unifikuese, vendime të Gjykatës Kushtetuese, të GJEDNJ-së, etj, lidhur me parimin e “gjësë së gjykuar” dhe “parimin e sigurisë juridike”, apo lidhur me faktin se kush përbën provë për rishikimin e vendimit (*vetëm ato prova të dala apo zbuluara pas vendimit të formë së prerë*), nën arsyetimin se është hetuar mbi të njëjtat prova duke i riadministruar ato. Subjekti ka pasqyruar në vendim edhe faktin se organi procedues që në pushimin e vendimit në 2013 ka arritur në konkluzion se vepra penale e heqjes së paligjshme të lirisë nuk është konsumuar ndërsa në këtë rifillim të hetimeve dhe dërgim të kërkesës për gjykim ka konkluduar se kjo vepër është kryer nga të dy shtetasit në bashkëpunim. Nën këto argumenta ligjorë dhe shumë të tjerë të pasqyruar gjerësisht në vendim, është arritur në pushimin e çështjes nga subjekti si gjyqtar i seancës paraprake.

Në kushte të tilla, sa i përket themelit të çështjes duket se nuk është kompetencë e Komisionit, duke pasur parasysh këtu edhe faktin se vendimi është ligjëruar nga një gjykatë e një shkalle më të lartë.

Nga ana tjetër, sikurse vërehet nga arsyetimi i vendimit, konstatohet se denoncuesi ka qenë pjesë përbërëse e procedimit penal njëherë si viktimë duke cilësuar si autor të ngjarjes kur është pyetur nga drejtuesi i prokurorisë, shtetasin M.L dhe më tej i proceduar penalisht për deklarim të rremë duke mohuar se njihje këtë shtetas (i njohur ndryshë si S.Ç), ndërsa ankohet për subjektin për vendimarrje të padrejtë në çështjen L, në një kohë kur është proceduar pikërisht se ka mohuar këtë autorësi në ngjarjen e ndodhur ndaj tij. Po ashtu ai pretendon për implikim të subjektit me avokaten B.B duke i atribuar subjektit këtë marrëdhënie si të ndikueshme në vendimarrje. Përkundër këtij pretendimi nga vendimi i subjektit rezulton se shtetasi L në këtë proces penal nuk është përfaqësuar nga kjo avokate por nga avokat S.H. Gjithashtu fakti që shtetasi K ka kërkuar në përfundim të gjykimit të kërkesës së organit të akuzës, pushimin e çështjes dhe më tej merr cilësinë e denoncuesit në Komision, duket se nuk e favorizon këtë të fundit në pretendimet e tij.

b/1 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë dokumentacionin mbështetës, duke u përqëndruar në pretendimin e denoncuesit lidhur me gjykimin dhe përfundimin e gjykimit në kohën e karantinimit total për shkak të COVID-19.

b/2 Subjekti në parashtrimet e saj fillimisht ka pretenduar se shtetasi Karaj si viktimë në çështjen penale por që ka ka mohuar që dy të pandehurit të jenë autorët e ngjarjes kundër tij nuk mund të ishte denoncuesi i këtij denoncimi. Për të provuar këtë fakt subjekti ka depozituar deklaratën noteriale të këtij shtetasi, ku mohon të jetë autori i këtij denoncimi.

Më tej subjekti ka sqaruar se çdo fjalë e thënë në denoncim është shpifje...Në lidhje me shqyrtimin e kësaj çështje gjatë karantinimit me lejoni tju shpjegoj se shqyrtimi i çështjeve gjyqësore gjatë karantinës janë rregulluar nga Akti Normativ nr.9, dt 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19” i cili në nenin 3 të tij parashikon se: “1. Seancat gjyqësore në çështjet administrative, civile dhe penale, të planifikuara pranë të gjitha

gjykatave, shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e Covid 19. 2. Nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e Covid 19 pezullohen afatet për ngritjen e padive, për paraqitjen e ankimeve si dhe për kryerjen e çdo veprimi procedural në çështjet administrative, civile dhe penale, sipas parashikimeve në këtë akt normative. Kur afatet fillojnë gjatë periudhës së pezullimit, ato shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë.

Në vijim subjekti është shprehur se rregullat sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen në këto raste:e) Në çdo çështje tjetër penale kur i pandehuri është i paraburgosur ose është duke vuajtur dënimin me burgimin, në rast se i pandehuri ose mbrojtësi i tij kërkojnë vazhdimin e gjykimit.” Në rastin konkret ndaj të pandehurit M.L (ka theksuar ajo) ishte caktuar masë sigurimi “arrest në burg” në mungesë e cila nuk ishte zbatuar, ndërsa i pandehuri E. Ç ishte me masë sigurimi “arrest me burg”, pra ishte në paraburgim. Kjo provohet nga fakti që ai ka lëshuar deklaratë noteriale përfaqësimi për avokaten e tij nga I EVP Elbasan dhe avokatja e tij me shkrim ka kërkuar vazhdimin e gjykimit, duke qenë kështu në përputhje me kriteret e kërkuara nga neni 3 pika e) të aktit normative të sipërcituar. Pra plotësohen dy kushtet e kërkuara nga akti normativ për zhvillimin e gjykimit që janë: i) i pandehuri është në paraburgim; ii) nga ana e avokates së zgjedhur prej tij është bërë kërkesë me shkrim për vazhdimin e gjykimit. Duke qenë se të dy të pandehurit akuzohen për një vepër penale të kryer në bashkëpunim rrjedhimisht do vazhdonte gjykimi për të dy ata pasi çështja nuk mund të ndahej. Pra ndryshe nga ajo që pretendohet në denoncim kam vepruar tërësisht në përputhje me Aktin Normativ nr.9/2020 të K.M. Subjekti ka depozituar:

- Deklaratën e lëshuar nga i pandehuri i paraburgosur E.Ç nga I EVP Elbasan.
- Kërkesën me shkrim të bërë nga avokatja e tij për vazhdimin e gjykimit.
- Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr.***, dt 30.04.2020 e cila ka vendosur pushimin e çështjes për këtë procedim penal.
- Vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës nr.***, dt. 23.09.2020 e cila ka vendosur të lërë në fuqi vendimin e ankimuar.
- Vendimin e pushimit date 26.12.2013 ku është vendosur pushimi i ndjekjes penale në lidhje me shtetasin M.L a S.C për këtë fakt penal.
- Aktin normativ nr.9 dt 25.03.2020.

b/3 Në vijim për këtë çështje, mbi denoncimin e radhës lidhur me vendimarrjen e Gjykatës së Lartë subjekti ndër të tjera ka parashtruar:

Në vendimin e arsyetuar thuhet se Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës e cila ka lënë në fuqi vendimin tim dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën e Apelit Durrës. Në mënyrë të përmbledhur në këtë vendim citohet se gjyqtari i seancës paraprake nuk mund të bëjë vlerësim të provave dhe të vendos pushimin e çështjes bazuar në këtë vlerësim edhe nëse rezulton se çështja është gjë e gjykuar. Sipas këtij vendimi gjyqtari i seancës paraprake ka një rol tërësisht pasiv i cili vetëm verifikon nëse hetimet janë të plota, nëse duhet të kryhen veprime të tjera hetimore, nëse provat janë të pavlefshme apo të papërdorshme. Gjithashtu arsyetimi vijon duke cituar se gjyqtari i seancës paraprake mund të bëjë pushimin e çështjes vetëm nëse konstaton se fakti penal nuk ekziston, ose nëse vepra penale nuk ekziston.

b/4 Subjekti nuk pajtohet me këtë arsyetim të Gjykatës së Lartë bazuar në nenet 332/dh dhe 328/1 të K.Pr.Penale, pasi ky vendim i Gjykatës së Lartë vjen në kundërshtim të hapur me përmbajtjen e këtyre dy neneve. Neni 332/dh të K.Pr.Penale nën titullin “Vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake” parashikon se: 1. Pasi dëgjon diskutimet e palëve, gjykata vendos: a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq, kur çmon se ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës; b) dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente, kur palët

paraqesin marrëveshje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit; c) dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi; ç) pushimin e akuzës ose të çështjes kur janë rastet e paragrafit 1, të nenit 328, të këtij Kodi.” Neni 328 paragrafi 1 i K.Pr.Penale nën titullin “Pushimi i akuzës ose çështjes” parashikon se: “1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: a) del qartë se fakti nuk ekziston; b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; c) viktimja nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij; ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet; d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhet të fillohet ose nuk duhet të vazhdojë; dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai; e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale; ë) i pandehuri vdes; f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj.”

Subjekti ka parashtruar se sipas nenit 332/dh pika ç) të K. Pr. Penale parashikohet se rastet kur gjyqtari i seancës paraprake vendos pushimin e çështjes janë rastet e parashikuara nga paragrafi i 1 i nenit 328 të K.Pr.Penale, raste të cilat i citova më lart dhe janë 9 të tilla. Në vendimin e saj Gjykata e Lartë shprehet se të vetmet raste kur gjyqtari i seancës paraprake mund të vendos pushimin e çështjes janë mungesa e faktit penal ose mungesa e veprës penale që janë pikat a) dhe b) të paragrafit të 1 të nenit 328 të K.Pr.Penale, duke i hequr kështu gjyqtarit të seancës paraprake kompetencat nga pika c) deri në pikën f) të këtij neni, kompetenca të cilat që ja ka njohur neni 332/dh pika ç) e Kodit.

Ndër të tjera, *subjekti ka sqaruar se*, rastet kur gjyqtari i seancës paraprake mund të vendos pushimin e akuzës ose të çështjes është rasti kur çështja është zgjidhur një herë me vendim të formës së prerë, pra kur jemi para gjësë së gjykuar sipas nenit 328/1 pika e) e tij. Shkaqet pse lindi gjyqtari i seancës paraprake ishin për të krijuar një filtër selektiv në mënyrë që jo çdo çështje të kalonte për shqyrtim në themel për të krijuar cilësi, shpejtësi në gjykim si dhe ekonomi gjyqësore. Për këtë arsye ligji i ka njohur atij të drejtën ta pushoj çështjen nëse konstaton secilin nga rastet e nenit 228/1 të K.Pr.Penale dhe jo vetëm dy rastet e para të tij. Gjyqtari i seancës paraprake ka detyrimin ta pushoj çështjen nëse konstaton se çështja është gjë e gjykuar sipas pikës e) të nenit 328/1 të Kodit, pasi kështu i ndërpret rrugën fillimit të një kalvari gjykimi të padrejtë dhe të pabazuar në ligj, bën ekonomi gjyqësore dhe jep drejtësi në kohë. Madje ky është qëllimi për të cilin u krijuan kjo figurë e posaçme e gjyqtarit. Figurë e cila nuk ka thjesht një rol formal siç pretendohet në këtë vendim të Gjykatës së Lartë, por ka disa kompetenca ligjore të detyrueshme për zbatim, kompetenca të cilat ja ka njohur vet ligjvënësi. Gjykata mund të bëjë interpretimin e një norme ligjore, por nuk mund të ndryshoj dhe as të kufizoj përmbajtjen e saj siç edhe ka ndodhur në rastin konkret nga Gjykata e Lartë, pasi kompetencën për pushimin e çështjes në rastet e gjësë se gjykuar gjyqtarit të seancës paraprake ja ka dhënë vet Kodi i Procedurës Penale neni 332/dh pika ç) e tij, kompetencë e cila nuk mund të hiqet apo kufizohet as me një vendim gjyqësor të Gjykatës së Lartë e të asnjë gjykate tjetër.

Subjekti konfirmoi se sipas nenit 328/1 pika dh) e Kodit, Gjykata e Lartë e njeh si një nga rastet kur gjyqtari i seancës paraprake mund ta pushojë çështjen dhe në fakt edhe kjo pikë e këtij neni është përdorur prej meje në arsyetimin e vendimit të pushimit e më konkretisht pika dh) *del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai, argument ky i përdorur prej meje për pushimin e çështjes.*

Por, ka theksuar subjekti, në mënyrë që një gjyqtar të arrijë në konkluzionin se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale ose nuk provohet ta ketë kryer ai do të thotë që duhet të analizohen provat në harmoni me njërën tjetrën e në përfundim të analizës së tyre të konkludohet nëse i

pandehuri e ka kryer veprën “*përtej dyshimit të arsyeshëm*” apo jo. Nëse po, çështja kalon për gjykim, e nëse jo çështja pushohet.

Pra, *shprehet subjekti*, duket se vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor pasi nga njëra anë thotë se gjyqtari i seancës paraprake mund ta pushojë çështjen nëse del që i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale ose nuk provohet ta ketë kryer ai, por nga ana tjetër thotë që gjyqtari i seancës paraprake nuk mund të analizojë parimin “*përtej dyshimit të arsyeshëm*”. *Lind pyetja*: Si mundet gjyqtari i seancës paraprake të konkludojë se nuk është kryer vepra penale nga i pandehuri apo se nuk provohet ta ketë kryer atë pa analizuar provueshmërinë e akuzës “*përtej dyshimit të arsyeshëm*” si i vetmi parim që ndan faktin nëse i pandehuri do mbajë apo jo përgjegjësi penale. Në mënyrë që gjyqtari i seancës paraprake të arrij në konkluzionin se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai duhet të bëj një vlerësim tërësor të provave përndryshe nuk mund të arrij në një konkluzion të tillë nga një vlerësim *prima facia* të tyre siç pretendon Gjykata e Lartë. Gjykata e Lartë thotë në vendimin e saj se gjyqtari seancës paraprake nuk analizon provat por verifikon a janë hetimet e plota. Por në fakt sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të RSH-së gjyqtari i seancës paraprake ka disa kompetenca si: vlerësimi i vlefshmërisë, pavlefshmërisë apo papërdorshmërisë së akteve të procedurale dhe konstatimi i tyre si të pavlefshme apo të papërdorëshme, verifikimi i plotësisë së hetimeve dhe kthimi i dosjes në rast mosplotësie të tyre, ka të drejtë të bëj ndryshimin apo shtimin e akuzës, ka të drejtë të ndryshojë kualifikimin juridik të veprës penale, ka të drejtë të pushojë çështjen në secilin prej 9 rasteve të nenit 328 parag 1 të Kodit. Kurrë asnjëherë në praktikën gjyqësore të të gjithë gjykatave të vendit por as edhe në trajnimet e ndryshme ku unë kam marrë pjesë nuk është shtruar ndonjëherë për diskutim ky qëndrim i Gjykatës së Lartë. Nuk ka patur asnjëherë qëndrime të ndryshme apo të kundërta në praktikën gjyqësore lidhur me këtë kompetencë të gjyqtarit të seancës paraprake.

Në çdo vendim, *ka cituar subjekti*, të dhënë nga ana ime por edhe nga çdo gjyqtar i RSH-së në cilësinë e gjyqtarit të seancës paraprake bëhet analiza e të gjitha provave dhe faktit penal të pretenduar nga organi akuzës si dhe analizon dhe i jep përgjigje gjithë pretendimeve të palës mbrojtëse.

Subjekti ka depozituar disa vendime të saj me objekt “*dërgim çështje në gjyq*” për të cilët sqaron se në secilin prej tyre ka analizuar ekzistencën e veprës penale dhe se pas analizës së saj ka vendosur “*kalimin në gjyq*” ose “*pushimin e akuzës/çështjes*”.

Subjekti është shprehur se, kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake janë aq të gjëra sa ai mund të përcaktojë edhe akuzën. Po ju vë në dispozicion disa vendime gjyqësore të dhënë prej meje por edhe vendime të kolegëve të ndryshëm ku kemi vendosur pushim çështje si gjyqtar të seancës paraprake sipas rasteve të parashikuara nga neni 328/1 të Kodit në rastet kur janë gjë e gjykuar, kur nuk provohet fajësia, kur nuk mund të dënohet, kur është parashkruar etj. Nga këto vendime rezulton se gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur pushimin e çështjes pas analizimit të hollësishëm e të detajuar të provave, pas vlerësimit të tyre në harmoni me njëra tjetrën, në secilin prej tyre është analizuar provueshmëria e veprës penale përtej dyshimit të arsyeshëm. Në dijeni time gjithë trupa gjyqësore e gjykatës ku unë kam ushtruar profesionin por edhe gjithë trupa gjyqësore e RSH-së nuk ka patur ndonjë dilemë apo paqartësi lidhur me zbatimin në praktikë të dispozitave procedurale penale ku përcaktohen kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake.

Në vijim ka shpjeguar se, Gjykata e Lartë nuk mund të marrë një rol aktiv dhe të zëvendësojë gjykatat e zakonshme në ushtrimin e kompetencës së tyre për interpretimin e dispozitës ligjore, duke bërë keqinterpretimi i tekstit së dispozitës së zbatueshme për zgjidhjen e çështjeve konkrete kur dispozita as nuk lë vend për keqinterpretime. Pra në rast se dispozita është e qartë dhe ka një interpretim dhe zbatim të unifikuar të saj nga të gjitha gjykatat e zakonshme, as që

ka vend për një interpretim të kundërt të saj nga një gjykatë më e lartë e sidomos kur kjo gjykatë bën interpretim të cunguar të dispozitës. Si rrjedhim ky vendim për mua “i çuditshëm” i Gjykatës së Lartë vjen në kundërshtim të hapur me dispozitat procedurale penale dhe me vendimmarrjet e të gjithë gjyqtarëve të RSH-së.

Subjekti ka qartësuar se nuk dinte që në praktikë të ketë patur ndonjë problematikë lidhur me zbatimin e këtij neni, as nuk di të ketë praktika të ndryshme, përkundrazi kjo është mënyra e vetme se si është interpretuar dhe zbatuar kjo dispozitë që në kohën e futjes në fuqi së saj në legjislacionin tonë, nga të gjithë gjyqtarët e Shqipërisë deri më sot. Nëse do qëndronte ky vendim i Gjykatës së Lartë do duhet të prishën me mijëra vendime dhënë nga gjithë trupa gjyqësore e RSH.

Sa më sipër, *është shprehur ajo*, në cilësinë e gjyqtarës së seancës paraprahe nuk kam kryer asnjë shkelje ligjore, asnjë shkelje procedurale, kam respektuar të drejtat dhe detyrimet që më ngarkon neni 332/dh pika ç) në referencë të nenit 328 pika 1) e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

Në vijim ka theksuar se, në rastin konkret Gjykata e Lartë konstaton se dy gjykatat më të ulëta kanë interpretuar në mënyrë të zgjeruar kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprahe, por në fakt është pikërisht kjo gjykatë që i ka bërë interpretim të ngushtuar atyre në kundërshtim të hapur me vet përmbajtjen e neneve 332/dh/ç dhe 328/1 të K.Pr.Penale. Në këtë rast, e shpreh me bindje se kam vendosur në përputhje me ligjin dhe të gjitha provat e administruara në gjykim, të cilat në harmoni me njëra tjetrën më diktuan pushimin e çështjes si një gjyqtare e pavarur, bazuar në ligj, prova dhe në bindjen time të brendshme. Ky vendim i Gjykatës së Lartë nuk është vendim njehsues në mënyrë që ti jap një interpretim përfundimtar kompetencave të gjyqtarit të seancës paraprahe, por është një vendim sporadik që ka zgjidhur një çështje konkrete duke bërë interpretimin e normave procedurale penale për të cilin kjo trupë gjyqësore ka vlerësim të ndryshëm nga gjyqtarët e shkallëve më të ulëta. Aq më tepër që ky vendim nuk ka prishur vendim e Gjykatës së Shkallës së Parë por vendimin e Gjykatës së Apelit. Fakti i ndryshimit të vendimeve nga një gjykatë më e lartë nuk nënkupton cilësi të ulëta profesionale, pasi përse kohë gjyqësori është i ndërtuar në 3 shkallë gjykimi, është tërësisht e mundur që secila prej shkallëve të ketë qëndrime të ndryshme lidhur me zgjidhjen e çështjes, pa nënkuptuar shkarkimin nga detyra të këtyre gjyqtarëve për këtë shkak.

Për sa më sipër është shprehur se, nuk ka bërë asgjë përveçse ka zbatuar dispozitat e detyrueshme procedurale penale lidhur me kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprahe, kompetenca të cilat Gjykata e Lartë i ka kufizuar në kundërshtim me përmbajtjen e tyre të qartë ligjore.

Përfundimisht, *subjekti ka cituar*, ky vendim nuk duhet të ketë ndikim në vlerësimin e aftësive të mia profesionale.

b/5 Unë si pakicë kam ndarë mendim ndryshe nga shumica e cila ka vlerësuar vetëm mbi deklaratën noteriale të këtij shtetasi i cili ka deklaruar se nuk e ka bërë ai denoncimin, jo vetëm për të pasqyruar vërtetësinë e denoncimit në raport me çështjen e gjykuar nga subjekti por edhe për faktin që në këtë rast ky akt /deklarata noteriale merr vëmendje, pasi nuk duket se bën logjikë që denoncuesi të jetë ky shtetas përse kohë në këtë proces gjyqësor ka qenë në cilësinë e viktimës, ka kërkuar vetë pushimin e çështjes, ka ndryshuar disa herë deklaratimet e tij për autorët e mundshëm të plagosjes ndaj tij. Në këto kushte kam krijuar bindjen se denoncuesi nuk është shtetasi që njëkohësisht ka nënshkruar deklaratën noteriale. Gjithashtu kam ndarë mendim ndryshe nga shumica edhe pse shprehet se *Në lidhje me procedurën kontatohet se nga ana e subjektit janë kryer veprime në tejkallim të kompetencave të saj të cilat janë konfirmua edhe nga Gjykata e Lartë, e cila nuk gjykon çështjen në themel dhe se Komisioni do të vlerësojë*

këto konstatime në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit që është kryer ndaj subjektit.”

Në vijim, për sa më sipër, kam arsyetuar dhe çmuar në analizë të fakteve dhe provave që rezultuan nga hetimi i këtij denoncimi.

Fillimisht mbi pretendimin e parë të njërit denoncues, nga verifikimi i akteve të depozituara vëren se konfirmohet përmbushja e kërkesave të legjislacionit të kohës për situatën kur gjykohej kjo çështje, më konkretisht konfirmohet dhënia e pëlqimit të njërit prej të pandehurve për të vijuar gjykimin e çështjes në kohën ku mbarë vendi përjetonte situatën e COVID19 e në këto kushte provohet se gjykimi është zhvilluar në përputhje me legjislacionin. Në tërësi përse është arsyetuar gjerësisht lidhur me këtë çështje për shkak të hetimit të kryer dhe ezaurimit të kërimit të Komisionit nga subjekti, nuk diktohen fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, pasi duke iu referuar edhe vendimit të pushimit të çështjes (të vitit 2013) nga një tjetër subjekt rivlerësimi, në kohën kur edhe pretendohet se ka ndodhur vepra penale për të cilën është akuzuar shtetasi L, duket se gjykata ka arritur në pushimin e saj pas një analizimi të gjerë të provave, kryerjes së disa akteve të ekspertimit, marrjes së deklarimeve, etj. Kam arritur në këtë vlerësim edhe përse kohë vendimarrja e subjektit është kontrolluar edhe nga gjykata më e lartë ajo e Apelit Durrës, e cila ka lënë në fuqi vendimin e subjektit të rivlerësimit. Duke qenë se çështja ka vijuar kontrollin e saj mbi bazë rekursi, për të cilën Gjykata e Lartë shprehet për tejkalim kompetence të gjyqtarit paraprak në vlerësimin e provave për të vendosur pushimin e çështjes, dhe se *gjyqtari i seancës paraparke mund të pushojë akuzën kur del qartë që fakti nuk ekziston*, ku konstatohet se Gjykata e Lartë me vendimin e saj drejtëpërdrejtë ka cënuar vendimin e Gjykatës së Apelit, si kontrollues i një gjykate më të ulët, pavarësisht faktit që çënohet edhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë. Në lidhje me shkeljen e cituar në adresë të vendimarrjes së subjektit, ajo që vihet re në këtë rast është fakti se duke iu referuar vendimit të pushimit të subjektit dhënë për këtë çështje, ndër të tjera është përdorur neni 328/e i K.Procedurës penale ku thuhet se *pushimi i akuzës mund të vendoset:...e) kur me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale*, ndërsa sipas vendimit të Gjykatës së Lartë thuhet se *Gjyqtari i seancës paraparke mund të pushojë akuzën kur del qartë që fakti nuk ekziston*. Çështja objekt hetimi ka qenë pushuar prej vitit 2013 për të njëjtën vepër penale në ngarkim të të njëjtit të dyshuar. Në fakt nga leximi literar i kësaj dispozite (nenit 328 të K.Pr.penale) vërehet se janë parashikuar disa raste kur vendoset pushimi i çështjes, ku një ndër to është edhe kriteri që ka zbatuar subjekti. Po ashtu vërehet se germa “ç” e nenit 332/dh të K.Procedurës Penale që citon Gjykata e Lartë dhe që njëkohësisht është përdorur nga subjekti në vendimarrjen e saj, përfshin në ombrellën e parashikimit të gjithë rastet e pikës 1 të nenit 328 të po këtij kodi, pra edhe parashikimin ku thuhet se *pushimi i akuzës/apo çështjes vendoset:...e) kur me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale*, dhe jo vetëm kriterin të cilit i referohet Gjykata e Lartë, se *pushimi i akuzës/apo çështjes vendoset vendoset kur del qartë që fakti nuk ekziston (neni 328/1/a)*. Nga ana tjetër vërehet se subjekti ka përdorur edhe nenin 328/1/dh të K.pr.penale ku thuhet se *pushimi i çështjes vendoset kur...dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai*. Kam vlerësuar se ky kriter në këtë rast është i lidhur ngushtësisht me vendimin e formës së prerë të vitit 2013 për të cilin ishte vendosur pushimi i çështjes për të njëjtin objekt hetimi dhe po ashtu vlerëson se për të pasur një vendimarrje të kësaj natyre padyshim që duhet bërë një verifikim i ndonjë elementi të ri. Për analogji, mund të thuhet se nëse organi i akuzës do të kërkonte pushimin e një çështjeje padyshim ai do të arsyetonte mbi bazë faktesh e provash për të bindur gjykatën në vendimarrje, pra nuk do të kishte një vlerësim sipërfaqësor. Nisur nga shpjegimet e subjektit, nga vendimet e depozituara prej saj për analogji të rastit, në të cilat pasqyrohet mbajtja e të njëjtit qëndrim, nga fakti i mungesës së një praktike unifikuese për çështje të kësaj natyre, si dhe nga ekzistenca e vendimit

të Gjykatës së Lartë, çmoj se një ndryshim i vendimit²⁹ nuk do të mund të jetë kriteri matës determinant³⁰ për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

- Përfundimisht rezulton se subjekti ka respektuar kërkesat e ligjislacionit procedural penal të parashikuara shprehimisht në nenin 332/dh/ç të K.Pr.Penale, e pavarësisht ndryshimit të këtij vendimi nga Gjykata e Lartë nuk mund të përbëjë shkak autonom për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga subjekti.

c. Denoncim³¹ i shtetas A.XH (A.Xh)

Denoncuesja ndër të tjera ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit për vendimarrje të padrejtë (për çështje të vitit 2017) në caktimin e masës së sigurimit personal dhe më tej ndryshimit të saj për dy ishadministratorët e kompanisë ***, nën pretendimin se kjo ka ndodhur nga ndikimi i avokatit mbrojtës të të akuzuarve.

i. Komisioni administroi³² dosjet gjyqësore në ngarkim të shtetasve K.Z (administrator i shoqërisë “***”) dhe Y.A (Drejtor i ***),

ii. Ndër të tjera vërehet se themeli i çështjes i referohet tregëtimit të skrapit, pra blerjes së tij në disa shoqëri, nga shoqëria ***, që sipas organit të akuzës shoqëritë shitëse nuk kanë ushtruar në aktivitetin e punës së tyre shitblerjen e *** dhe në këtë kontekst faturat e shoqërisë *** për këtë blerje kanë qenë fiktive me qëllim ligjërimitin e shumave të shlyera përmes bankës në favor të shitësve. Në kontekstin procedural vërehet se ndaj administratorit dhe drejtorit të shoqërisë është nisur me masat e sigurimit personal, kërkimet për zëvendësimin e tyre, etj. Kryesisht të dyshuarit janë përfaqësuar nga Av TH.S. Për të qëndruar në rolin dhe punën e subjektit të rivlerësimit në këtë çështje, nën pretendimet e denoncuesit, nga analizimi i akteve të administruara në dosjet gjyqësore rezultoi si vijon:

- Subjekti i rivlerësimit mbi kërkesën e organit të akuzës për caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg” kundër personit nën hetim K.Z, dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Mashtrimit”, kryer në bashkëpunim, dhe “Pastrimit të produkteve të veprës penale” ..., me vendimin e saj nr. ***, datë 19.07.2017 ka vendosur sipas kërkesës së organit të prokurorisë Elbasan. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin e saj nr. ***, datë 31.07.2017, duke u vendosur si masë e sigurimit personal ndaj këtij të dyshuari “*Ndalimi*

²⁹ Referuar edhe Vendimit nr.***, dt 13.07.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit në të cilin argumentohet se: “*Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë çështje, Kolegji konstaton se vendimmarrja e trupit gjykues ku qenë pjesë edhe subjekti, është cenuar prej vendimit të Gjykatës së Lartë, në drejtim të korrektësisë e zgjidhjes së saj, pavarësisht e Gjykata e Lartë ka përdorur në arsyetimin e saj se shkeljet lidhen me shkelje të natyrës procedurale, të cilat, konsideruar natyrën e procesit gjyqësor të zhvilluar, caktimin e masës së sigurimit, janë në thelb dispozitat që rregullojnë caktimin ose jo të një mase sigurimi, pra praktikisht zgjidhjen e çështjes. Kolegji konstaton gjithashtu se në thelb të kësaj vendimmarrje ka qëndruar vlerësimi që ka bërë trupi gjykues, në të cilin ka qenë pjesë edhe subjekti, mbi ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova si një kusht i detyrueshëm për vendosjen e një mase të sigurimit personal, sipas parashikimit të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale. Ky institut i së drejtës procedurale penale qëndron në vlerësimin e Kolegjit i lidhur ngushtë me bindjen e brendshme të gjyqtarit, të krijuar nga provat e administruara, se ka dyshim të arsyeshëm se vepra penale ka ndodhur dhe se personi ndaj të cilit do të vendoset masa e sigurimit, e ka kryer atë. Sipas vlerësimit të Kolegjit, përcaktimi nëse bindja e brendshme e trupit gjykues rreth dyshimit të arsyeshëm, në rastin konkret, ka qenë e duhura apo e drejta, del jashtë kompetencave të organeve të rivlerësimit, për sa kohë lidhet drejtpërdrejt me korrektësinë e vendimmarrjes bazuar në bindjen e brendshme, pra me atë aspekt të aftësive profesionale të magjistratëve që nuk mund të gjykohej e të shërbejë si matës i aftësive të tyre profesionale në kuadër të këtij procesi. Arsyetimi i mësipërm gjen mbështetje në nenin 44, paragrafi 1 i ligjit nr. 84/2016, i cili referon te kriteret e ligjit nr. 96/2016, si kriteret që duhen analizuar në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve, i cili në referencë të fundit, sipas nenit 72, pika 4 e këtij ligji, ndalon vlerësuesin të çmojë aftësitë gjyqësore duke gjykuar korrektësinë e vendimmarrjes apo themelin e çështjes. Për pasojë, në përfundim të këtij arsyetimi, Kolegji çmon se shkeljet e trajtuara se janë kryer nga subjekti në gjykimin e kësaj çështje, të lidhura ngushtësisht në rastin konkret me bindjen e brendshme të magjistratit, nuk mund të shërbejnë si gjetje të cilat duhet të analizohen në këndvështrim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit”.*

³⁰ Sikurse shprehet Kolegji në vendimin e saj Nr. ***, datë 23.10.2020, konkretisht në pikën 12.5.

³¹ Nr.*** prot, datë 18.11.2021

³² Me shkresën nr. *** prot, datë 06.12.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan

*i daljes jashtë territorit shtetëror shqiptar për personin nën hetim...”. Vendimi i apelit është rekursuar dhe gjykata e lartë me vendimin e saj nr. ***, datë 2.11.2017 ka vendosur mospranimin e rekursit.*

- Subjekti mbi kërkesën e shtetasit K.Z për zëvendësim të masës së sigurimit nga “ Ndalimi i daljes jashtë territorit shtetëror shqiptar për personin nën hetim...” në “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, me vendimin e saj nr. ***, datë 23.12.2017, ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë. Nga leximi i vendimit vërehet se organi i akuzës në procesverbalin e datës 23.12.2017, ka shprehur mosdakortësinë e zëvendësimit të masës duke qartësuar se “nuk jemi përpara asnjë kushti për zëvendësim, nuk ka ndryshuar asnjë nga kushtet, nuk u provua dhe nuk u paraqit asnjë provë nga pala kërkuese që duhet të udhëtojë për shkak të detyrës për lidhjen e kontratave me të huaj që pretendohet, duke qenë se nuk ka ndryshuar asnjë kërkesë nga neni 260 i K.Pr.penale...”

- Më tej, përsëri mbi kërkesën e personit nën hetim K.Z, subjekti në gjykimin e zëvendësimit të masës së sigurimit personal, pasi ka arsyetuar kushtet dhe rrethanat e reja sipas nenit 260 të K.Pr.Penale të cilat mundësojnë zëvendësimin e masës (si depozitimi i një kontrate individuale punësimi e lidhur me një tjetër shoqëri, vërtetimi i shoqërisë punëdhënëse se detyrat e specifikuar për tu kryer dhe përmbushur prej tij kërkojnë udhëtime jashtë vendit, si dhe dokumentacioni që pasqyrojnë qënien e tij si anëtar në këshillin mbikëqyrës të shoqërisë “****” sh.a.) ka vendosur me vendimin e saj nr.***, datë 20.01.2018, pranimin e kërkesës.

- Duket se në këtë rast organi i akuzës (i përfaqësuar nga e njëjta prokurorë) nuk ka adresuar kontestim procedural se çështja duhej të gjykohej nga gjyqtari i seancës paraprake, përveçse referuar procesverbalit të seancës gjyqësore (shih fq me numërtim 224 në dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr.***, datë 27.01.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, si dhe parashtrimet datë 20.01.2018 me numërtim 244 e vijim) ku vërehet se ka kërkuar rrëzimin e kërkesës.

- Në parashtrimet e saj në datë 20.01.2018, përfaqësuesi i organit të akuzës ka kërkuar rrëzimin e kërkesës duke theksuar ndër të tjerë faktin e avancimit të ndryshimit të pozitës procedurale të kërkesës nga “person nën hetim” në “të pandehur” dhe dërgimin në datë 10.01.2018, në gjykatë të “Kërkesës për dërgimin në gjyq të çështjes penale nr.***”.

- Nga aktet e administruara në dosje rezulton se shtetasi Z, në datë 16.01.2018, *pra pas depozitimit të kërkesës për gjykim*, ka depozituar kërkesën për zëvendësimin e masës, kërkesë për të cilën subjekti ka kryer veprime procedurale në datë 17.01.2018 duke caktuar zhvillimin e seancës gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës në datë 20.01.2018, datë në të cilën edhe ka vendosur pranimin e saj. Gjykimi i kërkesës dhe për pasojë edhe vendimarrja e subjektit duket të jetë ndërmarrë në kundërshtim me nenin 260/4 të K.Pr. penale, përse kohë çështja ishte adresuar për gjykim përpara depozitimit të kërkesës, për zëvendësimin e masës së sigurimit personal.

- Më tej, mbi ankimin e organit të akuzës (ku në Apelin kundërshtues nga përfaqësuesi i Prokurorisë së Apelit Durrës është trajtuar çështja e moskompetencës nga subjekti në gjykimin e kërkesës së zëvendësimit të masës së sigurimit), çështja është kthyer për rigjykim për tu gjykuar nga gjyqtari kompetent (ai i seancës paraprake), nga ku është vendosur përsëri sikurse kishte vendosur subjekti më parë, pra ndryshimi i masës së sigurimit personal të kundërshtuar nga organi i akuzës, vendim ky i lënë në fuqi nga gjykata e Apelit me vendimin nr.***, datë 08.05.2018.

- Në vijim, subjekti i rivlerësimit mbi kërkesën e organit të akuzës për caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg” kundër personit nën hetim Y.A, dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Mashttrimit”, kryer në bashkëpunim më shumë se një herë dhe me pasoja të rënda, me

vendimin e saj nr. ***, datë 19.07.2017 (të formës së prerë), ka vendosur sipas kërkesës së organit të prokurorisë Elbasan.

- Më tej, me vendimin e saj nr.***, datë 02.02.2018, mbi kërkesën e të dyshuarit Y.A (i hetuar në procedimin penal të regjistruar ndaj tij me nr. ***), ka vendosur zëvendësimin e masës ndaj të dyshuarit Y.A nga “Ndalimi i daljes jashtë territorit shtetëror shqiptar për personin nën hetim...” në “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, duke përcaktuar edhe ditën dhe orën e paraqitjes së tij në çdo muaj. Në këtë rast organi i akuzës ka ngritur probleme procedurale nën kontekstin se nuk duhet që këtë kërkesë ta gjykonte subjekti, por gjyqtari i seancës paraprake, duke qenë se çështja kishte shkuar për gjykim, nisur nga parashikimet e reja të bëra në K.Pr. Penale në vitin 2017. Nga aktet e administruara vërehet se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar me vendimin e saj të ndërmjetëm, nr.***, datë 26.01.2018, “Për shpalljen e moskompetencës” rolin dhe pozitën e saj në raport me legjislacionin procedural, me të cilën ka vendosur rrëzimin e kërkesës, si dhe ka bërë me dije organin e akuzës mbi mënyrën e shortimit të çështjes, me qëllim shmangien e dyshimeve për njëanshmërisë në gjykimin e kërkesës me këtë të dyshuar dhe njëkohësisht ka kërkuar edhe dorëheqjen nga gjykimi i kërkesës (*sikurse vihet re kjo kërkesë duket ti ketë paraprirë çdo dyshimi të organit të akuzës për shkak të pranimit më parë të zëvendësimit të masës së sigurimit personal ndaj personit në hetim K.Z*), ndërsa rezulton se kjo kërkesë nuk është pranuar nga drejtuesi i gjykatës. Në kushte të tilla ka vijuar gjykimi nga subjekti i rivlerësimit i përmbyllur me pranimin e kërkesës për zëvendësimin e masës sikurse u citua më sipër. Pas rikthimit të çështjes vërehet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin e saj nr.***, datë 11.04.2018, vendim i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. **, datë 15.05.2018, ka vendosur sërish (por me një trup gjykues të përbërë prej tre gjyqtarësh) sikurse kishte vendosur subjekti, zëvendësimin e masës ndaj të dyshuarit Y.A nga “Ndalimi i daljes jashtë territorit shtetëror shqiptar për personin nën hetim...” në “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”. Ajo që vërehet në këtë çështje me dy të dyshuar (hetuar nën të njëjtin procedim penal nr.***), është fakti se organi i akuzës (i përfaqësuar nga e njëjta prokurorë) nuk ka adresuar të njëjtin kontestim procedural në kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga shtetasi K.Z, nga “Ndalimi i daljes jashtë territorit shtetëror shqiptar për personin nën hetim...” në “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, përveçse referuar procesverbalit të seancës gjyqësore (shih fq me numërtim 224 në dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr.***, datë 27.01.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, si dhe parashtrimet datë 20.01.2018 me numërtim 244 e vijim) ku ka kërkuar rrëzimin e kërkesës. Edhe në gjykimin e zëvendësimit të masës së sigurimit personal të shtetasit K.Z, subjekti i rivlerësimit pasi ka arsyetuar kushtet dhe rrethanat e reja sipas nenit 260 të K.Pr.Penale të cilat (sipas arsytimit) mundësojnë zëvendësimin e masës (si depozitimi i një kontrate individuale punësime e lidhur me një tjetër shoqëri, vërtetimi i shoqërisë punëdhënëse se detyrat e specifikuar për tu kryer dhe përmbushur prej tij kërkojnë udhëtime jashtë vendit, si dhe dokumentacioni që pasqyrojnë qënien e tij si anëtar në këshillin mbikëqyrës të shoqërisë “****” sh.a.) ka vendosur me vendimin e saj nr.***, datë 20.01.2018, pranimin e kërkesës. Mbi ankimin e organit të akuzës, çështja është kthyer për rigjykim për tu gjykuar nga gjyqtari kompetent (ai i seancës paraprake), nga ku është vendosur përsëri sikurse kishte vendosur subjekti më parë, pra ndryshimi i masës së sigurimit personal të kundërshtuar nga organi i akuzës, vendim ky i lënë në fuqi nga gjykata e Apelit me vendimin nr.***, datë 08.05.2018.

- Rezultoi se subjekti i rivlerësimit në tërësi në këtë çështje, me vendimin e saj nr.***, datë 19.07.2017 ka caktuar edhe masën e sigurimit pasuror të sekuestros preventive mbi llogaritë bankare të personit nën hetim shoqëria “****” sh.a., në të gjithë bankat e nivelit të dytë që operojnë në Republikën e Shqipërisë, sikurse është kërkuar nga organi i akuzës. Megjithë qëndrimin e organit të akuzës për të mos u pranuar ankimi i ushtruar nga personi nën hetim/shoqëria, gjykata e Apelit Durrës me vendimin e saj nr. ***, datë 31.07.2017 ka

ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë duke hequr masën e sekuestros preventive vetëm mbi llogaritë rrjedhëse të shoqërisë tregtare “****” sh.a, që shërbejnë si likuiditet për pagat e punonjësve të kësaj shoqërie.

- Përgjithësisht duket se zbutja e masës së sigurimit fillimisht nga *arrest me burg në ndalim të daljes jashtë territorit shtetëror shqiptar për personin nën hetim...*, është pranuar nga një gjykatë më e lartë, pas rrëzimit të dhënë me vendimet e subjektit, mbi disa kërkesa të të dyshuarve. Po ashtu momenti i pranimit të kërkesës së të dyshuarve për ndryshim të mëtejshëm të masës së sigurimit personal nga “Ndalimi i daljes jashtë territorit shtetëror shqiptar për personin nën hetim...” në “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, duket të jetë pranuar nga subjekti vetëm pas përmbushjes së kushteve të nenit 260 të K.Pr. penale, pra pasi këto kërkesa janë rrëzuar një herë për mungesë provash. Gjithashtu, duket se edhe qëndrimi i organit të akuzës (përfaqësuar nga i njëjti prokuror) në secilën kërkesë për zëvendësim të masës, pranuar me vendim nga subjekti, nuk ka qenë i njëjtë sa i përket kontekstit procedural, se kërkesa duhej të gjykohej nga trupa gjyqësore e hetimit paraprak.

Në rastin e të dyshuarit K.Z, përfaqësuesi i organit të akuzës ka kërkuar rrëzimin e kërkesës së zëvendësimit të masës nën pretendimin se nuk janë mospërmbushur kushtet e parashikuara në nenin 260 të K.Pr.Penale, ndërsa në rastin e të dyshuarit Y.A, organi i akuzës ka kërkuar mos shqyrtimin e kërkesës së zëvendësimit të masës së sigurimit personal nën kontekstin e parashikimeve të reja të K.Pr.penale se kërkesa të tilla duhet të shqyrtohen nga gjyqtari i seancës paraprake. Vërehet se çështjet thuajse janë shqyrtuar në të njëjtën kohë ndërsa nga organi i akuzës duket të mos jetë ngritur i njëjti pretendim procedural në seancë por vetëm më tej në apelin kundërshtues. Gjithësesi duket se konteksti procedural ka marrë udhë nga vendimarrjet e gjykatës së Apelit të cilat kanë adresuar gjykimin pikërisht tek kjo trupë/pra tek gjyqtari kompetent. Në të dy rastet konstatohet se kjo e fundit ka vendosur njëjtë sikurse kishte vendosur subjekti i rivlerësimit në kërkesat për zëvendësimin e masës së sigurimit personal dhënë ndaj të dyshuarve, vendime të cilat megjithë apelin kundërshtues të organit të akuzës, kanë mbetur në fuqi. Edhe në kontekstin e pretendimit të denoncuesit se vendimarrjet janë ndikuar nga avokati i çështjes, duket se problematikat në vendimarrje nuk kanë të bëjnë me rolin e përfaqësuesit ligjor në këtë çështje, për më tepër kur çështjet i janë nënshtruar gjykimit në shkallët më të larta.

c/1 Për sa më sipër, dukej se subjekti ka gjykuar në kundërshtim me nenin 260/4 të Kodit të Procedurës Penale, kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj këtyre shtetasve, nga “Ndalimi i daljes jashtë territorit shtetëror shqiptar për personin nën hetim...” në “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, pasi gjykimi i saj/kërkesës, ka vijuar në kushtet kur më parë në gjykatë ishte depozituar kërkesa e organit të akuzës për dërgimin në gjyq të çështjes penale dhe për këtë shkak i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

Gjithashtu, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të qartësojë vijimësinë e këtij procesi, në kontekstin e statusit të gjykimit të themelit të procedimit penal të regjistruar ndaj këtyre shtetasve, si dhe të depozitohë dokumentacion në mbështetje të shpjegimeve të dhëna.

c/2 Subjekti ndër të tjera ka parashtruar:

Deklaratën noteriale³³ të shtetasës A.XH me detyrë *** në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan e cila ka mohuar të ketë paraqitur këtë denoncim, përdorimi i emrit të saj në këtë denoncim është bërë nga persona të panjohur prej saj dhe se për shkak të detyrës së saj si sekretare gjyqësore (*është shprehur deklaruesja*) nuk jam në gjëndje të analizoj vendimarrjet gjyqësore.

³³ Nr. *** rep, nr.*** kol, datë 13.01.2022

Në vijim, për personin nën hetim K.Z, subjekti ka treguar në mënyrë kronologjike procedurën e ndjekur lidhur me caktimin prej saj të masës së sigurimit personal *arrest me burg*, rivendosjen po prej saj pas verifikimit të kushteve, ndryshimin e masës nga një gjykatë më e lartë në “Ndalimin e daljes jashtë territorit shtetëror shqiptar”, zëvendësimin e masës prej saj në “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, arsyet e konsiderimit për zëvendësimin e masës së sigurimit personal, vendimarrje kjo e dhënë pas përsëritjes së kërkesës së rrëzuar më parë, për shkak të mosparaqitjes së provave shkresore për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve. Para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me datë 16.01.2018, është paraqitur kërkesa penale Nr.*** Akti, me kërkuar K.Z. Me anë të kësaj kërkesë, ai ka kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit “Ndalimi i daljes jashtë territorit shtetëror shqiptar për personin nën hetim K.Z” në “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” duke i bashkëlidhur kërkesës disa prova shkresore. Bazuar në analizën e provave, në ligj dhe në bindjen e brendshme kam vlerësuar se kërkesa ishte e bazuar në ligj dhe në prova dhe e kam pranuar atë.

Subjekti ka shpjeguar se ky vendim është ankimuar më pas nga organi akuzës me argumentin që vendimi që ka bërë zëvendësimin është i padrejtë dhe se duhet të ishte shqyrtuar nga gjyqtari i seancës paraprake mqns çështja kishte shkuar për gjykim.

Në vijim ka sqaruar se ky pretendim nuk është ngritur nga prokurorja gjatë gjykimit tek kërkesat paraprake, por vetëm në ankim para Gjykatës së Apelit. Ky vendim është ndryshuar më pas nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.***, dt 14.02.2018 me argumentin që masa duhet të shqyrtohet nga ku ndodhen aktet (përfshi edhe atë të seancës paraprake) duke e kthyer çështjen për gjykim tek gjyqtari kompetent.

Po ashtu ka qartësuar se, në vijim një gjyqtar tjetër i Gjykatës Elbasan ka vendosur pranimin e kërkesës (siç kisha disponuar unë më pare) me vendimin nr.*** dt 11.04.2018 dhe ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.***, dt 08.05.2018.

Edhe për personin nën hetim Y.A, subjekti ka parashtruar në mënyrë kronologjike vendimarrjet lidhur me caktimin prej saj të masës arrëst me burg, ndryshimin e masës në “Ndalimin e daljes jashtë vendit”, nga e njëjtë gjykatë por nga një tjetër subjekt, rrëzimin e kërkit të mëtejshëm të këtij shtetasi në datë 19.12.2017 për zëvendësimin e masës në *detyrim paraqitje në policinë gjyqësore*, kërkesë e cila është përsëritur në datë 16.01.2018 për të cilën bazuar në analizën e provave, në ligj dhe në bindjen e brendshme kam vlerësuar se kërkesa ishte e bazuar në ligj dhe në prova dhe e kam pranuar atë. Nga ana e Organit të prokurorisë u paraqit kërkesë për moskompetencë funksionale kërkesë e cila u rrëzua nga gjykata me argumentin se me Ligjin Nr. 35 të vitit 2017 u bën ndryshimet në K.Pr.Penale, të cilat hynë në fuqi më datën 1 Gusht 2017. Me ndryshimet që ka pësuar K.Pr.Penale është krijuar figura e gjyqtarit të seancës paraprake kompetencat e të cilat janë disiplinuar nga ligji procedural penal në dispozita të shpërndara. Neni 278/2 i K.Pr.Penale parashikon se: “*Kërkesat e palëve gjate hetimeve paraprake, sipas paragrafit 1, të këtij neni, shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar*”. Nga kjo dispozitë ligjore rrjedh se shqyrtimi i kërkesave që lidhen me hetimet paraprake vazhdojnë të shqyrtohen nga gjyqtari i hetimeve deri në çastin që aktet i kalojnë gjyqtarit të themelit.

Subjekti ka cituar dispozitat ligjore lidhur me rastin. Neni 260 pika 4 të K.Pr.Penale ka parashikuar se: “*Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga gjykata ku ndodhen aktet, brenda pesë ditëve nga depozitimi i saj. Kur është rasti, gjykata vendos edhe kryesisht revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit gjatë marrjes në pyetje të personit të arrestuar, sipas nenit 248, të këtij Kodi, në rastet e parashikuara nga paragrafi 6, i nenit 246, të tij, gjatë procedimit për sigurimin e provës, gjatë seancës paraprake ose gjatë gjykimit.*”. Pra dispozita i jep mundësinë gjyqtarit të seancës paraprake që të shqyrtojë kërkesën për zëvendësimin apo ndryshimin e masës së sigurimit vetëm nëse ajo ngrihet nga i pandehuri në seancë, gjatë shqyrtimit të

kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq. Pra në asnjë dispozitë ligjore nuk thuhet shprehimisht që nëse është bërë kërkesë për dërgim çështje në gjyq kompetente për shqyrtimin e masës së sigurimit është gjyqtari i seancës paraprake. I vetmi rast kur gjyqtari i seancës paraprake mund të vendos për zëvendësimin e masës së sigurimit (është shprehur subjekti), është kur vet i pandehuri vendos ta parashtojë këtë kërkesë rishitas gjatë seancës paraprake, pra gjatë kohës që është duke u zhvilluar kjo seancë. Pavarësisht se neni 260 pika 4 të K.P.Penale parashikon se: *“Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga gjykata ku ndodhen aktet...”* kam çmuar se ky parashikim nuk mund të merret i shkëputur por duhet të bëhet interpretim sistematik në raport me të gjitha dispozitat e tjera ligjore për të vlerësuar se cili ka qenë qëllimi i ligjvënësit.

Ajo ka sqaruar se në rastin konkret prokurorja nuk e ngriti çështjen e moskompetencës për të pandehurin tjetër K edhe pse pohoi në seancë se çështja kishte kaluar për gjykim. Arsyeja e mosngritjes së këtij pretendimi ishte sepse në dt 23.12.2017 kisha vendosur rrëzimin e kërkesës për të njëjtin kërkues për mungesë provash. Prokurorja duke menduar se do rrëzohej edhe kërkesa e re, nuk ngriti asnjë pretendim lidhur me kompetencën funksionale. Në çështjen e dytë ajo e ngriti këtë pretendim vetëm sepse unë kisha pranuar kërkesën e parë dhe donte të shmangte një vendim të dytë në favor të kërkuesit tjetër. Pra veprimet e prokurores nuk janë konsekuente, ndërsa unë si gjyqtare kam parimin që duhet të ruaj konsekuencën dhe standardin e vendimeve të dhëna prej meje në çdo rast.

Në vijim (subjekti është shprehur) prokurorja e çështjes paraqiti një kërkesë për përjashtimin tim, kërkesa e cila është rrëzuar me vendimin nr.*** dt 30.01.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nga një gjyqtare tjetër e kësaj gjykate. *Në lidhje me mendimin me shkrim që kisha dhënë para gjyqtarit që po shqyrtonte kërkesën për përjashtim jam shprehur se e lë në vlerësim të tij nëse ka vend për tu përjashtuar apo jo. Referuar pretendimeve të ngritura në kërkesën për përjashtim gjykata bazuar në parimin kushtetues që drejtësia jo vetëm të bëhet por edhe duhet të shihet që po bëhet, për ti hapur rrugë dhe për ti dhënë mundësi organit të prokurorisë që të gjykohej nga një gjyqtar i paanshëm në dukje vendosa ti kërkojë kryetarit të gjykatës heqjen dorë nga gjykimi i kësaj çështje. Ky i fundit me vendimin e dt 31.01.2018 vendosi rrëzimin e kërkesës me argumentin që masat e sigurimit kanë karakter personal dhe zëvendësimi i masës së sigurimit për një person nën hetim nuk nënkupton paragjykim të çështjes edhe për një person tjetër nën hetim. Si rrjedhim, është urdhëruar vazhdimi i gjykimit nga ana ime.*

Subjekti ka shpjeguar edhe në lidhje me procedurën e ndjekur për zbatimin e nenit 260/4 të K.Pr.Penale duke theksuar:

- Me ndryshimet legjislativ të vitit 2017 është futur figura e gjyqtarit të seancës paraprake si një figurë e re, e panjohur më parë. Si rrjedhim kishte paqartësi në ligj dhe nuk kishte praktikë të konsoliduar lidhur me faktin se kush do e shqyrtonte kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit kur ishte depozituar kërkesa për dërgim çështje në gjyq. Ndryshimet legjislativ kanë filluar të zbatohen në shtator të vitit 2017, ndërsa unë kam shqyrtuar këto kërkesa vetëm 4 muaj pas këtyre ndryshimeve në një kohë që praktika gjyqësore ishte e rrahur me dy figura gjyqtarësh atë të hetimeve paprake dhe atë të themelit.

- Në kuadër të konsolidimit të praktikave në mbedhjen e përgjithshme të gjyqtarëve kur diskutojme risitë që sjellin ndryshimet legjislativ dhe qëndrimet që do mbajmë lidhur me zbatimin e tyre në rast paqartësie ligjore, kemi mbajtur qëndrimin që në një situatë të tillë çështja do gjykohej nga gjyqtari i hetimeve paraprake bazuar në argumentat që kam dhënë në vendimin e ndërmjetëm të arsyetuar. Kjo është arsyeja pse kërkesa më ka ardhur mua për shqyrtim nga kryetari i gjykatës dhe jo gjyqtarit të seancës paraprake.

- Në kuptimin administrativ kur paraqitet kërkesë për zëvendësim masë siguri ajo nuk

regjistrohët dhe as nuk hidhet në short, por ciklohet nga kryetari i gjykatës dhe shkon tek gjyqtari kompetent që është gjyqtari i hetimeve paraprake. Pra fakti që çështja është cikluar nga kryetari i gjykatës për të ardhur për shqyrtim tek mua, tregon praktikën që ishte vendosur në gjykatën tonë në diskutimet me trupën gjyqësore.

- Siç vihet re nga RIV që ju kam vënë në dispozicion rezultojnë se çështja me kërkues Koray Zeytinoglu është regjistruar në dt 16.01.2018 dhe po në këtë datë është bërë kalimi tek mua nga kryetari i gjykatës duke u bërë shënimi “*U bë kalimi i dosjes me objekt urgjent tek gjyqtari E.Kapedani*”, ndërsa çështja me kërkues Y.A është regjistruar në gjykatë në dt 22.01.2018 dhe duke qenë se atë javë gjyqtar i gatshëm ka qenë gjyqtari T.K sistemi e ka çuar automatikisht tek ky gjyqtar, por më pas ka ndërhyrë administrativisht kryetari i gjykatës dhe ka bërë kalimin me ciklim për kalimin e çështjes tek gjyqtari kompetent siç provohet nga RIV ku është bërë shënimi “*gjyqtari i vjetër T.K, gjyqtari i ri E.Kapedani. Arsyeja e ndryshimit (i kalohet gjyqtarit që ka kryer veprimet paraprake)*. Unë kam rrëzuar kërkesën për moskompetencë funksionale të prokurorës pasi ishte bindja ime dhe mënyra se si e interpretoja nenin 260/4 të K.Pr.Penale, lidhur me gjyqtarin e seancës paraprake si një figurë e re procedurale (vetëm 4 muaj pas ndryshimit ligjor dhe me asnjë rast praktikë) në harmoni me dispozitat e tjera procedurale të cilat i kam analizuar me vendim të ndërmjetëm.

Subjekti ka dhënë disa arsye pse kompetent duhet të ishte gjyqtari i hetimeve paraprake edhe pse çështja ka kaluar për gjykim është se gjatë seancës paraprake gjyqtari mund të vendosë kthimin e akteve për hetime të mëtejshme. Si rrjedhim gjyqtar i masave mbetet përsëri ai i hetimeve paraprake. Arsye tjetër pse gjyqtari i hetimeve paraprake duhet të shqyrtojë kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit është edhe shpejtësia e gjykimit që kërkon zëvendësimi i masës së sigurimit i cili është 5 ditë, ndërsa kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq nga gjyqtari i seancës paraprake shqyrtohet brenda 30 ditëve. Në rastin konkret për personin nën hetim K.Z kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit është regjistruar në dt 16.01.2018 dhe është shqyrtuar në dt 20.01.2018 pra brenda 4 ditëve, ndërsa për personin nën hetim Y.A kërkesa është regjistruar në dt 22.01.2018 ndërsa seanca e parë është caktuar në dt 26.01.2018, pra pas 4 ditësh. Ndërsa kërkesa për dërgimin e çështjes për gjykim është regjistruar në dt 12.01.2018 është shortuar tek gjyqtarja M.C në dt 15.01.2018 dhe po atë ditë është planifikuar seanca paraprake për në dt 15.02.2018 pra brenda afatit 30 ditor dhe rezultojnë të jetë shqyrtuar në këtë datë pra në dt 15.02.2018.

Subjekti ka depozituar disa raste praktike ku (sipas subjektit) provohet bindja që kjo kërkesë mund të shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake nëse paraqitet *gjatë seancës paraprake* sipas nenit 260/4 të K.Pr.Penale.

Pra, *ka theksuar subjekti*, në praktikë është konsoliduar fakti që palët e paraqesin kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit gjatë kohës që është duke u zhvilluar seanca gjyqësore paraprake, në rastet kur është bërë kërkesë për dërgimin e saj në gjyq nga prokurori.

Subjekti ka sqaruar se është jo vetëm e pamundur por edhe ligjërisht e ndaluar që gjyqtari i seancës paraprake të shqyrtojë zëvendësimin e masës së sigurimit veçmas nga kërkesa për dërgimin në gjyq. Gjyqtari i seancës paraprake zhvillon vetëm një gjykim dhe aty mund të shqyrtohen të dyja kërkesat. Termi “*gjykata ku ndodhen aktet*” i referohet fazës së hetimit dhe gjykimit në themel dhe jo fazës së seancës paraprake, pasi në këtë të fundit zëvendësimi i masës së sigurimit mund të bëhet vetëm nëse pala e paraqet kërkesën për zëvendësim gjatë zhvillimit të seances paraprake.

Subjekti ka depozituar disa raste praktike gjatë punës së saj ku (sipas saj) rezultojnë se gjatë seancës gjyqësore të shqyrtimit të kërkesës për kalimin e çështjes për gjykim, palët paraqesin aty për aty kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit. Në praktikë, ka paqartësi për mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të dispozitës procedurale duke bërë që ata ta paraqesin

kërkesën për zëvendësim e masës në seancë gjyqësore. Madje ka raste praktike edhe kur organi procedues (pavarësisht se është njohës i mirë i ligjit dhe i praktikave gjyqësore) e paraqet kërkesën për zëvendësim mase sigurimi në seancë. Në praktikën time të punës (*është shprehur subjekti*) që nga viti 2018 deri 2021 nuk ka ndodhur asnjë rast që pala të paraqes në sekretarinë e gjykatës kërkesë për zëvendësim e masës së sigurimit pas regjistrimit të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjykim, për shkak të paqartësisë ligjore për mënyrën e respektimit të afatit 5 ditor, si rrjedhim gjithmonë e paraqesin atë gjatë shqyrtimit të kërkesës për dërgimin e çështjes për gjykim. Pra pengesa e parë për shqyrtimin e masës së bashkë me seancën paraprake brenda afatit 5 ditor është në lidhje me pamundësinë e njoftimit të të gjithë palëve në proces përfshi edhe viktimën brenda këtij afati, pasi për njoftimin e viktimave duhen minimalisht 15 ditë. Madje i njëjti qëndrim është mbajtur edhe në gjykata të ndryshme të vendit. Më konkretisht po ju paraqes një vendim të ngjashëm të sjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë vendimi nr.***, dt 11.02.2020 (3 vjet pas ndryshieve legislative) nga e cila rezulton se jemi para situatës kur po shqyrtohet kërkesa për zëvendësim masë sigurimi ndërkohë që është regjistruar në gjykatë kërkesa për dërgimin e çështjes për gjykim. Paravësisht kësaj gjyqtari i hetimeve ka vazhduar gjykimin e saj dhe për këtë shkak prokurori ka paraqitur ankim kundër vendimit të tij, duke pretenduar se vendimi ishte dhënë nga gjyqtari jo kompetent, por në vijim Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur mospranimin e ankimit pasi prokurori i apelit ka hequr dorë nga ankimi.

Subjekti ka qartësuar se në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë as nuk është bërë arsyetimi në vendim pse është ai gjyqtari kompetent dhe as nuk i ka kthyer përgjigje pretendimit të prokurorit për çështjen e moskompetencës funksionale. Pra rezulton se ky qëndrim është mbajtur dhe vazhdon të mbahet edhe nga gjykata të tjera në vend, pikërisht për shkak të paqartësisë në ligj. Madje vendimi i gjykatës së Lezhës është dhënë në vitin 2020 dhe ende mbahet një qëndrim i tillë, për shkak të paqartësisë ligjore dhe moskonsolidimit të praktikave në të gjithë gjykatat e vendit dhe mungesës së një vendimi njesues të Gjykatës së Lartë lidhur më këtë problematikë. Faza e gjykimit në seancë paraprake është një fazë tranzitore *sui generis* me kompetenca të kufizuara dhe paqartësi ligjore lidhur me kompetencat e plota të saj, e sidomos 4 muaj pas miratimit të ndryshimeve legislative.

Për zbatimin e nenit 260/4 të K.Pr. Penale, *subjekti ka shpjeguar se*, ka praktika të ndryshme të mënyrës së interpretimit dhe zbatimit të saj në praktikë. Por për këtë çështje ende nuk është marrë ndonjë vendim njesues nga kjo gjykatë. Përsa kohë kohëzgjatja e masave të sigurimit gjatë seancës paraprake konsiderohet si fazë hetimi paraprak atëherë edhe shqyrtimi i kërkesave për këto masa duhet të bëhet nga gjyqtari i hetimit paraprak. Në praktikën gjyqësore ndodh shpesh që gjyqtar të ndryshëm të kenë qëndrime të ndryshme lidhur me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave materiale dhe/ose procedurale. Ajo çka verifikohet në këto rast nga organet kontrolluese të gjyqësorit si KLGJ, ILD, etj, është fakti nëse shkelja ka ndodhur me keqbesim dhe lë vend dyshim për përfitime të paligjshme të gjyqtarit dhe nëse ka sjellë pasoja të rënda dhe të pariparueshme për palët, duke dëmtuar të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme.

Në rastin konkret, *ka cituar subjekti*, të gjitha rrethanat që karakterizojnë rastin konkret si: ndryshimet ligjore, paqartësia në ligj, futja e figurës së një gjyqtari të ri të seancës paraprake si një figurë e panjohur më parë, mungesa e praktikës gjyqësore, argumentat e dhëna në vendimin e ndërmjetëm, heqja dorë nga çështje me vullnet të lirë, trajtimi i kësaj faze si fazë e hetimeve paraprake përsa i përket masave të sigurimit dhe kohëzgjatjes së tyre etj, në tërësinë e tyre tregojnë se unë nuk kam patur asnjë qëllim për mbajtjen e dosjes në kundërshtim me ligjin e aq më pak të kem patur ndonjë qëllim të posaçëm për mënyrën e interpretimit të saj, por ka qenë bindja ime e brendshme bazuar në një interpretim sistematik dhe logjik të të gjithë dispozitave ligjore, argument të cilave ju qëndroj edhe sot. Pra interpretimi i kësaj dispozite i cili më pas rezultoi i gabuar ka ardhur për shkak të bindjes në mirëbesim dhe jo për shkak të

keqbesimit apo qëllimeve të posaçme të paligjshme. Kurrësesi, është shprehur ajo, nuk i kam favorizuar të pandehurit, pasi masa e sigurimit detyrim paraqitje është më e rëndë se ndalimi i daljes jashtë vendit dhe unë jam gjyqtarja që ka vendosur ndaj tyre masën “arrest në burg” masa të cilat ja kanë hequr gjyqtar të tjerë. Pra është e qartë që jo vetëm që nuk kam favorizuar palën, por e kam rënduar atë duke i caktuar një masë sigurimi më të rëndë (me dëshirën e tij) thjesht dhe vetëm për ta lejuar atë të ushtrij të drejtën kushtetuese “*të drejtën për të punuar*”.

Subjekti ka sqaruar se kishte caktuar ndaj dy personave nën hetim masën e sigurimit “arrest në burg”, masë e cila ju është hequr atyre nga gjyqtar të tjerë. Pra “ndalimi i daljes jashtë shtetit” (*është shprehur ajo*) është më e lehtë se “detyrim paraqitje”, por i pandehuri ka zgjedhur një masë më të rëndë vetëm për shkak të natyrës së punës së tij e cila e detyronte të lëvizte jashtë shtetit. Në vijim ndaj këtyre të pandehurve janë dhënë vendime ekzaktësisht të njëjta si vendimet e dhëna prej meje dhe janë lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës. Pra në thelb zgjidhja ka qenë e drejtë, dhe interpretimi i dispozitës procedurale nuk ka sjellë asnjë dëm. Ai vendim është riparuar menjëherë nga gjyqtari tjetër, madje siç e theksova më lart ai ka dhënë vendime ekzaktësisht të njëjta dhe janë vlerësuar të drejta nga gjyqtarët më të lartë. Fakti që me vullnetin tim (ka theksuar subjekti) kam paraqitur kërkesë për dorëheqje do të thotë se nuk kam patur kurrësesi qëllim në vetvete që të mbaja dosjen në mënyrë të padrejtë, por se ashtu e interpretoja dispozitën procedurale në harmoni me dispozitat e tjera lidhur me gjyqtarin e seancës paraprake, aq më tepër duke qenë një figurë e re procedurale dhe pa praktikë të konsoliduar. Të gjithë këto hapa provojnë se vendimi i dhënë prej meje nuk i ka sjellë asnjë dëm hetimit, gjykimit, palëve apo drejtësisë.

Në lidhje me vijimësinë e këtij procesi ajo ka qaruar se për këtë çështje organi akuzës ka kërkuar tërheqjen e të gjithë akuzave dhe shuarjen e masave të sigurimit për gjithë të pandehurit dhe në përfundim gjykata ka vendosur pafajësi për të gjithë ata. *Si rrjedhim, dukshëm jemi para një rasti që nuk ka asnjë shkelje, nuk ka asnjë abuzim, nuk ka asnjë vendim të padrejtë përse i përket themelit të çështjes, e vetmja gjë që ka është ligësia dhe shpifja e atyre që nuk dinë të ndalen as kur nëpër rreshtat e denoncimeve dhe nëpër dosjet e denoncuaras dalin shkeljet e tyre, e them këtë sepse kam bindjen që kjo çështje është denoncuar nga Prokuroria Elbasan.*

Subjekti ka depozituar:

- Vendimin e ndërmjetëm për moskompetencën.
- Vendimet e zëvendësimit të masave të sigurimit nga gjyqtarët e themelit.
- Vendimin e pafajësisë.
- Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe ankimin e prokurorit.
- Disa vendime në praktikën e punës së subjektit ku palët kanë kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore.

c/3 Unë si komisionere në pakicë kam ndarë mendim ndryshe nga shumica e cila ka vlerësuar mbi bazë të deklaratës noteriale të kësaj shtetase e cila ka deklaruar se nuk e ka bërë ajo këtë denoncim. Pë këtë çështje kam të njëjtin qëndrim sikurse kam arsyetuar më sipër e për rrjedhojë çmoj të mos bie në përsëritje.

Në vijim vlerësoj që arsyetimi të përqëndrohet në gjykimin e çështjes dhe provueshmërisë së të dhënave në denoncim për të kuptuar në të vërtetë edhe publiku rolin, punën dhe nivelin profesional të subjektit të rivlerësimit, për të perceptuar në këtë formë vëzhguesi i jashtëm raportin e cenimit të besimit të publikut, etikën e magjistratit dhe nivelin profesional të subjektit. Në mendimin ndryshe gjithashtu ka ndikuar edhe vlerësimi i shumicës po për këtë çështje, që krahas vlerësimit për deklaratën noteriale shprehet edhe lidhur me pretendimin e denoncuesit duke konkluduar se *Në lidhje me procedurën kontatohet se nga ana e subjektit*

janë kryer veprime në tejkalim të kompetencave të saj të cilat janë konfirmua edhe nga gjykata më e lartë. Komisioni do të vlerësojë këto konstatime në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit që është kryer ndaj subjektit.”

Në këto kushte kam vlerësuar të arsyetoj mendimin ndryshe duke u bazuar në provat e administruara, porë në raport me legjislacionin e përdorur në çështje të kësaj natyre.

Si fillësë vërehet se subjekti ka synuar të ezaurojë, të japë detaje dhe të interpretojë legjislacionin në këndvështrim të vendimarrjeve të dhëna, që gjithnjë sipas saj janë marrë në kushte edhe të bindjes së brendshme, mënyrës individuale të interpretimit ligjor pa ndikim apo prirje. Në këtë çështje kam vlerësuar se duhen trajtuar dy situata. Së pari kemi të bëjmë me çështjen e zëvendësimit të masës së sigurimit, pra a ka qenë gjykata në kushtet e pranimit të kërkesës. Ndërsa, çështja e dytë lidhet me faktin nëse kjo kërkesë duhej gjykuar nga gjyqtari i hetimit paraprak apo ai i seancës paraprake.

Lidhur me çështjen e parë nëse ishte gjykata në kushtet e pranimit të kërkesës për zëvendësim të masës së sigurimit, vërehet se nga subjekti në vendimarrje është arsyetuar avancimi i situatës në favor të të dyshuarve nga masa e parë ajo e arrestit me burg duke cilësuar disa të dhëna të tjera. Në këtë drejtim, është arsyetuar mbi pozitat e të pandehurve në shoqërinë ***** sh.a dhe njëkohësisht mbi punësimet e tyre edhe në një tjetër shoqëri sikurse i dyshuari i parë, në “*****” sha në cilësinë e këshilltarit për tregtimin dhe shitblerjen brenda dhe jashtë Shqipërisë, që në këtë këndvështrim është gjykuar se ndalimi i udhëtimit jashtë vendit do të ndikonte në lidhjen e kontratave të ndryshme të shoqërisë. U vërejt se për këtë analiza kanë shërbyer si burim prove Kontrata Individuale Pune të lidhura me këtë shoqëri, ku në pikën 2 të kontratës përcaktohet “*Këshilltar mbi tregtimin dhe shitblerjen brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë*”. Kjo kontratë është shoqëruar edhe me ekstraktin e QKR-së së Shoqërisë “*****” sha dt 18.01.2018 e cila vërteton ekzistencën e kësaj shoqërie.

Po ashtu në dosje është administruar edhe një vërtetim (nr.*** Prot, dt 19.01.2018), ku pasqyrohen detyrat që kërkuesi ka, kontratat e shitblerjeve që kjo shoqëri ka kryer me blerës të ndryshëm nga të cilat rezulton se malli blihet jashtë vendit (kontratat administruar në dosje), librat e blerjeve të shoqërisë nga ku rezulton se blerjet bëhen kryesisht jashtë vendit dhe kërkuesi ka detyrën e këshilltarit për blerjet (librat e blerjeve administruar në dosje), si dhe kontratat e blerjes ku përcaktohet një vend i huaj për përmbushjen e kontratës.

Në këndvështrimin ligjor vërehet se masa e sigurimit personal tanimë kishte nisur më parë zëvendësimin e saj duke u paraprirë nga ajo e ndalimit të udhëtimit jashtë vendit dhe që për pasojë, më tepër se provueshmëria për të prezantuar nevojën e daljes jashtë vendit, do duhej të ishte krijimi i bindjes nga gjykata i kompleksuar me rrethana të tjera të cilat të krijojnë sigurinë se zëvendësimi i masës nuk do të mund të shërbente të dyshuarit për një moskthim të mundshëm. Prandaj dhe dispozita ligjore (neni 260/2 i K.Pr.Penale) në zbatueshmërinë e saj përcjell një situatë sa të përgjithshme dhe aq të përveçme për të arsyetuar në harmoni provat me kushtet e krijuara nga njëra masë siguri në tjetrën, ndërthurur edhe me bindjen e brendshme. Nga aktet nuk u provua e kundërta, pra largimi i shtetasve në kushtet e përfitimit nga zëvendësimi i masës së sigurimit personal, përpos faktit të rezultuar më pas deri në pafajësi të të dyshuarve.

Një element i rëndësishëm në këtë vlerësim gjithashtu është edhe fakti se një gjykatë më e lartë e cila bën kontrollin e vendimarrjes në këtë rast ka ndryshuar vendimin e subjektit lidhur me procedurën e gjykimit se kërkesat duhet të ishin gjykuar nga gjyqtari i seancës paraprake por pa u shprehur lidhur me pranimin e kërkesës për zëvendësimin e masës dhe në vijim u konstatua

se gjykata e radhës ka vendosur³⁴ gjithashtu zëvendësimin e masës së sigurimit me detyrim paraqitje në policinë gjyqësore.

Në lidhje me çështjen e radhës sa i përket gjyqtarit i cili duhet të bënte zëvendësimin e masës së sigurimit personal, referuar aspektin procedural, paraprkisht vërejmë se afatet kohore në këto vendimmarrje mbeten standarde përse ato janë parashikuar dhe njëkohësisht të tilla mbeten edhe për shqyrtimin e kërkesave të dërguara për gjykim.

Në këtë kuptim duket se ka një divergjencë në shqyrtimin e masës së sigurimit, pasi në të njëjtën gjykatë dhe njëkohësisht në intervale të shkurtra kohore është regjistruar kërkesa për zëvendësimin e masës dhe po ashtu edhe kërkesa për gjykim e çështjes. Duke ditur që afati i gjykimit të kësaj të fundit ka parashikuar gjykimin brenda 30 ditëve dhe përmbushjen e këtij detyrimi duke njoftuar palët me qëllim pjesëmarrjen e tyre po brenda një afati të caktuar kohor, atëherë zëvendësimi i masës së sigurimit (sikurse është rasti në fjalë) duket se bëhet i pamundur të shqyrtohet nga e njëjta gjykatë (pra nga gjyqtari paraprak) brenda 5 ditëve, afat ky që gjithashtu është detyrues për tu zbatuar në këto tipologji çështjesh.

Neni 260/4 i k.Procedurës Penale, ka parashikuar: 4. *Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga gjykata ku ndodhen aktet, brenda pesë ditëve nga depozitimi i saj...*

Nisur nga terminologjia e parashikuar:

i) *Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga gjykata ku ndodhen aktet*, që në këtë rast në këtë gjykatë janë depozituar dy kërkesa të ndryshme ku për secilën diktohet një afat i ndryshëm, që në këtë rast për shqyrtimin e kërkesës së zëvendësimit të masës së sigurimit afati rezulton të jetë brenda pesë ditëve,

ii) nga fakti që në kërkesën e parë të zëvendësimit të masës, megjithë hyrjen në fuqi të ndryshimeve ligjore në K.Pr.penale përfaqësuesi i organit të akuzës nuk i ka kërkuar gjykatës shqyrtimin e kërkesës nga gjyqtari paraprak por thjesht dhe vetëm është mjaftuar me diskutimin përfundimtar për rrëzim e saj,

iii) nga fakti që subjekti në vijim duket të ketë marrë masa për të korigjuar situatën e mëparshme duke kërkuar gjithashtu dorëheqjen në kërkesën e dytë të zëvendësimit për shtetasin tjetër, kërkesë kjo e papranuar,

iv) nga fakti që siglimi i të dy çështjeve pra i kërkesës së zëvendësimit të masës së sigurimit personal dhe i kërkesës së dërguar nga organi i prokurorisë për gjykimin e çështjes është bërë nga drejtuesi i institucionit i cili thjeshtësisht mund të kishte marrë masa për dërgimin e kërkesës gjyqtarit paraprak,

v) nga fakti që duke analizuar vendimin gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë³⁵ nën të njëjtin objekt kërkimi, e depozituar nga subjekti i rivlerësimit, vërehet se nga përfaqësuesi i organit të akuzës është ushtruar ankimi lidhur me çështjen e kompetencës dhe më tej nuk rezulton që gjykata e Apelit Shkodër të jetë shprehur për kompetencën në vendimmarrjen³⁶ e saj, duke mos identifikuar në këet mënyrë një standard për shqyrtimin e këtyre lloj kërkesave nga gjyqtari i seancës paraprake,

³⁴ me vendimin nr.*** dt 11.04.2018 dhe ky vendim është lënë në fuqi nga gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.***, dt 08.05.2018 për shtetasin K.Z dhe me vendimin nr.*** dt 11.04.2018 dhe ky vendim është lënë në fuqi nga gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.***, dt 15.05.2018, Y.A.

³⁵ Nr.***, datë.11.02.2020

³⁶ Nr.***, datë 04.03.2020

vi) nga fakti që në kohën e shqyrtimit të kërkesave, ndryshimet ligjore penale sapo kishin hyrë në fuqi, çka do të thotë se kërkojnë kohën e tyre për tu implementuar,

vii) nga fakti që u konstatua se ende vijojnë të mbahen qëndrime të ndryshme në drejtim të shqyrtimit të këtyre kërkesave,

viii) nga fakti që ende nuk ka një vendim unifikues për *gjykatën/gjyqtarin* që duhet të shqyrtojë ekzaktësisht këtë lloj kërkesë, gjithnjë në këndvështrim të parashikimeve të reja ligjore,

konkludoj se kjo çështje në çfarëdo lloj leximi që mund ti bëhet dispozitës ligjore, nuk passjell cenim të të drejtave të palëve, por mbetet në nivelin e krijimit të një praktike unifikuese nga Kolegji i Gjykatës së Lartë. Nga ana tjetër edhe në kushtet që Komisioni nuk mund të zëvendësojë logjikën e interpretimit të subjektit, si dhe në referencë të jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit³⁷ çmoj se nuk evidentohen rrethana që subjekti mund të penalizohet për trajtimin e kësaj çështje në aspektin e rivlerësimit profesional.

ç. Denoncim³⁸ i shtetasit B.M dhe shtetasit K.B

Në lidhje me këtë denoncim shumica ka vlerësuar se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse në lidhje me ndryshimin e masës së sigurimit, por veprimet e subjektit në këtë rast nuk mund të përbëjnë shkak autonom për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit ndaj subjektit.

Për sa më sipër ndaj mendim ndryshe duke përshtuar denoncimin dhe analizuar si në vijim:

Denoncuesit ankohen se subjekti i rivlerësimit ka marrë para nga shtetasi T.S (kontigjent krimi) nga Peqini për të liruar nga arresti me burg me një masë më të butë trafikantin e drogës në Elbasan M.B, nën argumentet se gjoja ky shtetas ka fëmijë të sëmurë dhe babain duke i vdekur me qëllim për ta liruar nga burgu. Gjithashtu njëri prej denoncuesve ka cituar se policia nuk vepron për shkak të lidhjeve që subjekti ka me përfaqësues të këtij institucioni. Paraprakisht u konstatua se denoncuesit nuk identifikojnë ndonjë lidhje të drejtëpërdrejtë në këtë çështje, apo të jenë prekur a cënuar në këto vendimarrje.

Komisioni administroi³⁹ dosjen gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me nr.*** Akti, datë 19.12.2020 me të pandehur shtetasin M.B, gjykuar nën akuzën e vleftësimit të masës së arrestit.

Nga aktet e administruara në dosjen objekt gjykimi rezulton se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarës së vetme me vendimin nr.***, datë 19.12.2020 ka vendosur pranimin e kërkesës së organit të prokurorisë. Vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të personit nën hetim M.B i dyshuar për kryerjen e veprave penale « Prodhimi dhe shitja e narkotikëve », parashikuar nga neni 283/1 i K. Penal. Caktimin e masës së sigurimit personal « Arrest me burg » për personin nën hetim M.B. Pas ankimit të ushtruar ndaj vendimit, rezulton se Gjykata e Apelit Durrës me vendimin e saj nr. ***, datë 05.01.2021 ka miratuar vendimin e shkallës së parë.

Në vijim Komisioni ka administruar⁴⁰ dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr.***, datë 16.03.2021 me objekt, *zëvendësim mase sigurimi*.

Nga aktet e administruara rezultoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin e saj nr.***, datë 16.03.2021, ndër të tjera ka arsyetuar edhe kushtet dhe rrethanat e reja të pashqyrtuara më parë në vendosjen e masës së sigurimit “arrest me burg”. Në vendim është argumentuar mbi gjendjen familjare dhe ekonomike të të pandehurit, gjendjen shëndetësore të

³⁷ Shih vendimin nr.***, datë 13.07.2020/ pika 21.3 dhe 21.4 dhe vendimin nr.***, datë 23.10.2020, pika 12.5 dhe 16.

³⁸ I ardhur me e-mail në datë 28.01.2021 dhe po me e-mail në datë 16.03.2021

³⁹ Me shkresën nr.*** Prot, datë 08.04.2020

⁴⁰ Referuar shkresës nr.*** prot, datë 15.07.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

prindërve të cilët kanë nevojë për përkujdesje, për gjendjen psikologjike të vajzës së të pandehurit e cila rezultoi të marrë seanca këshillimi nga psikologjia e shkollës, për gjendjen shëndetësore të vetë të pandehurit, diagnozën e konkluduar ndaj tij, sipas QSUT-së⁴¹, fakti se ai është përdorues dhe në vartësi të rëndë nga drograt, sugjerimet e mjekut për të mos qëndruar në ambiente të mbyllura, por të përfshihet në terapi grupi nëpërmjet programeve afatgjatë psikosociale në qendra rehabilitimi, etj. Nga verifikimi i këtyre akteve mbi të cilët është argumentuar, rezultoi se disa prej tyre janë lëshuar pas vendosjes së masës së sigurimit personal “arrest me burg”, apo edhe pas kërkesës së organit të akuzës (datë 17.12.2020)⁴² drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për caktimin e masës së arrestit me burg. Po nga aktet rezultoi se pas masës së sigurimit personal “arrest me burg” është regjistruar procedimi penal ndaj këtij shtetasi dhe se për të kanë nisur procedurat hetimore. Ndër të tjera në arsyetimin e vendimit të subjektit për ndryshimin e masës së sigurimit, citohet se nga organi i prokurorisë në njoftimin e akuzës, është cituar se nuk u provua bashkëpunimi dhe se në vendimarrje është mbajtur në vëmendje edhe sugjerimi i Ministrisë së Drejtësisë për përdorimin e masave të tjera të sigurimit nga ajo e arrestit me burg për shkak të situatës së pandemisë COVID 19. Përkundër këtij vendimi dhe arsyetimi, mbi ankimin e paraqitur nga organi i akuzës, gjykata e Apelit Durrës ka vendosur me vendimin e saj nr. ***, datë 20.04.2001 ndryshimin e vendimit të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (dhënë nga subjekti)...rrëzimin e kërkesës së shtetasit B për ndryshimin e masës së sigurimit...”. Në këtë vendim ndër të tjera citohet se a) rrethanat familjare dhe fakti që i arrestuari ka qenë përdorues i lëndës narkotike, rezultoi në njohur nga gjykata e shkallës së parë që në vendosjen e masës së sigurimit personal “arrest me burg”, si dhe fakti që b) çështja është regjistruar dhe për të ka një çështje penale gati për gjykim, pasi në fillimin e muajit mars 2021 janë mbyllur hetimit dhe është kërkuar dërgimi i çështjes në gjyq.

Për sa më sipër duket se vendimarrjet i janë nënshtruar debatit gjyqësor dhe shqyrtimit të provave të paraqitura nga palët në proces. Nga ana tjetër zgjidhja e çështjes i përket themelit dhe se mënyra e saj nuk është në kompetencë të Komisionit. Në tërësi nuk u diktuan parregullsi apo shkelje të natyrës procedurale, si zvarritje në proces, mosadministrim aktesh, mosnjoftimi palëve për zhvillimin e seancave, etj. Megjithatë, Komisioni ka ftuar subjektin të japë shpjegime më të detajuara në raport me argumentët e vendimit të gjykatës së Apelit Durrës, siç përshkruhet më sipër në germën (a) dhe (b) si dhe ii) të qartësojë mbi vijimësinë e këtij procesi, në kontekstin e gjykimit të themelit të procedimit penal të regjistruar ndaj këtij shtetasi.

ç/1 Subjekti ndër të tjera ka parashtuar:

Lidhur me çështjen me të pandehur M.B rezultoi që nga ana ime është caktuar fillimisht masë sigurimi “*Arrest në burg*”, brenda një afati të shkurtër dhe të shpejtë prej 48 orësh. Në këtë seancë nuk është paraqitur dhe as është marrë në shqyrtim asnjë provë e palës mbrojtëse, përveç kërkesës dhe provave të paraqitura nga organi prokurorirë dhe janë ngritur disa pretendimeve me gojë nga pala mbrojtëse. Në vijim në dt 25.01.2021 nga ana e personit nën hetim është paraqitur kërkesë me objekt zëvendësimin e masës së sigurimit nga “*Arrest në burg*” në një masë më të lehtë sigurimi. Kërkuesi ka paraqitur disa prova⁴³ mbi të cilat pretendon se nevojat e sigurimit janë zbutur dhe se duhet të bëhet zëvendësimi i saj.

⁴¹ Reflektuar në vlerësimin klinik për këtë shtetas, dokument që mban datën 22.01.2021.

⁴² Administruar në dosjen gjyqësore penale që i përket vendimit të masës së arrestit me burg, nr. ***, datë 19.12.2020

⁴³ vërtetimin nr.*** prot, dt 16.12.2019 i Bashkisë Elbasan Njësia Administrative nr.*** ku rezultoi se shtetasi M.B ka sjellje të mirë në komunitet dhe jeton në një familje prej 8 anëtarësh; një karakteristikë e lëshuar nga kjo Njësi Adm e cila provon faktin se familja B vuan nga probleme sociale dhe ekonomike; çertifikata familjare që provon faktin se familja B përbëhet nga 8 anëtarë; vërtetimin e lëshuar nga Njësia Adm nr.*** që provon se vëllezërit e tij jetojnë jashtë shtetit në Itali; vërtetimin nr.*** prot dt 30.12.2020 lëshuar nga Drejtoria e Qendrës Ekonomike të Arsimit i cili provon faktin se vajza e mitur M.B ndjek çerdhen publike nr.*** në Elbasan; vërtetimin dt 18.12.2020 dhe dt 30.12.2020 lëshuar nga Shkolla 12 vjeçare jopublike “***” e cila provon faktin se vajza tjetër e mitur M.B ndjek klasën e tretë në këtë shkollë dhe se ndaj saj ndiqen seanca këshillimi

Provat i janë nënshtruar debatit gjyqësor dhe nga ana e prokurorisë nuk pati asnjë pretendim lidhur me vërtetësinë, autenticitetin apo përmbajtjen e tyre. I vetmi argument i dhënë nga organi akuzës është rrezikshmëria shoqërore e autorit dhe e veprës penale bazuar kryesisht në dyshimet që ai mund ta kishte kryer veprën në bashkëpunim me persona të tjerë për të cilët po priteshin përgjigjet e akteve të ekspertimit teknik të telefonit të tij celular nga ku mund të dilnin bashkëpunëtorët. Pas kalimit të çështjes në konkluzione përfundimtare organi procedues në seancën e ardhshme ka kërkuar të riçelet hetimi gjyqësor pasi gjatë asaj periudhe kishte mbërritur në prokurori akti i ekspertimit teknik të telefonit celular, rezultatet e të cilit ishin në kundërshtim me dyshimin e prokurorisë pasi në analizë të tij nuk rezultonte që personi nën hetim ta kishte kryer veprën penale në bashkëpunim me persona të tjerë.

Vendimi që bëri zëvendësimin e masës së sigurimit 1 muaj më pas u ndryshua nga Gjykata e Apelit e cila e riktheu në burg personin nën hetim, por në asnjë rresht të këtij vendimi nuk jepet ndonjë argument nëse Gjykata e Shkallës së Parë kishte gabuar, nëse po, cilin ligj procedural apo material kishte shkelur gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e apelit ka krijuar një bindje tjetër vetëm lidhur me faktin nëse janë zbutur apo jo nevojat e sigurimit, dhe nuk ka bërë asnjë analizë të provave të marra në shqyrtim nga unë si gjyqtare e shkallës së parë.

Në asnjë rresht të vendimit të gjykatës së apelit nuk janë marrë në shqyrtim provat lidhur me kushtet personale dhe familjare të personit nën hetim. Nuk është shqyrtuar vlera dhe fuqia e tyre provuese dhe as ndikimi që ato mund të kenë për të zëvendësuar masën e sigurimit.

Pretendimet e tij/të dyshuarit në fazën e caktimit të masës së sigurimit mbetën në nivelin e pretendimeve me karakter deklarativ dhe të paprovuar dhe nuk janë marrë në shqyrtim nga imë si gjyqtare...ndërsa në fazën e zëvendësimit të masës së sigurimit prej tij janë paraqitur një mori provash.

Në një sërë vendimesh të saj Gjykata e Strasburg-ut ka theksuar faktin se elemente si “rrezikshmëria e veprës penale”, “rrezikshmëria e personit” apo “rreziku i ikjes”, nuk mund dhe nuk duhet të referohen në mënyrë të përgjithshme nga gjykata. Ato duhet të analizohen dhe provohen rast pas rasti duke u marrë në konsideratë nga gjykata përveç parashikimeve ligjore (lloji i veprës dhe marzhi i dënimit) edhe moshja e të pandehurit, arsimit, gjendja familjare dhe sociale, të cilat do ta çonin gjykatën në konkluzionin se i dyshuari do i shmangej hetimit apo gjyqimit. ... Për sa i përket rrezikut të largimit, GJEDNJ-ja gjithashtu ka deklaruar se ai nuk mund të matet vetëm në bazë të ashpërsisë së dënimit të mundshëm që personi rrezikon, por duhet të vlerësohet duke iu referuar disa faktorëve të tjerë të rëndësishëm, si veçanërisht, karakteri i personit, morali i tij, shtëpia, profesioni, pasuria, lidhjet familjare dhe

për shkak të një aksidenti të ndodhur më parë; vërtetimet nga qëndrat shëndetësore për të dy prindërit e M shtetasi V dhe N. B ku provohen problemet shëndetësore që ata kanë, si dhe faktin që askush tjetër nuk mund të kujdeset për ta; një vlerësim klinik për personin nën hetim M.B lëshuar nga QSUT i cili konkludon se diagnozë mjekësore është “*Vartësi e rëndë nga lëndë drogë cocaine dhe lëndë drogë heroinë. Situacion craving. Të fillojë farmakoterapinë me antagonist duke e këshilluar lidhur me efektet e kundërta të përdorimit të preparatit, të zgjidhet preparati në bashkëpunim me shtetasin M.B dhe familjarët e tij.*” Rekomandime mjekësore: “*Shtetasi M.B zhvillon situacionin “craving” për lëndën drogë cocaine dhe lëndën drogë heroinë dhe është mirë të tregohet kujdes sepse ka nevojë për mbështetje ose këshillim psiko-social sepse mund të ndjej nevojën për konsumim të lëndës drogë cocaine duke bërë relaps në përdorimin abuzues.... tërheqja në një mjedis me një mbikqyrje profesionale me ose pa mjekim është më i udhës me rrethanat e lartpërmendura për shkak të çrregullimeve psiko emocionale këshillohet të mos qëndrojnë në ambiente të mbyllura, duhet të përfshihet në terapi grupi nëpërmjet programeve afat gjate psiko sociale në Qendra Rehabilitimi. Rekomandohet që vlerësimet psiko sociale të ndiqen në mënyrë periodike çdo 3 javë nga psikolog klinik gërshetuar me terapi farmakologjike”; rekomandimin e dhënë nga mjeku toksikolog klinik pranë QSUT që duke qenë se ai vuan nga çrregullime psiko emocionale, këshillohet të mos qëndrojnë në ambiente të mbyllura, të përfshihet në terapi grupi çdo tre javë.*

të gjitha lidhjet e tij me shtetin ku ai po ndiqet penalisht, si dhe lidhjet e tij ndërkombëtare (çështja ‘Neumeister kundër Austrisë’, GjEDNj, 27 qershor 1968, para. 10; çështja ‘Smirnova kundër Rusisë’; çështja ‘Letellier kundër Francës’, GjEDNj, 26 qershor 1991, para. 43).

Në rastin konkret, referuar edhe standardeve dhe praktikës ndërkombëtare kam marrë në konsideratë faktin që hetimet kanë përfunduar dhe qënia e tij në gjendje të lirë nuk mund të rrezikonte më marrjen ose vërtetësinë e ndonjë prove, kam marrë në konsideratë gjendjen e tij shëndetësore ku ai duhet të ndiqte mjekime dhe programe rehabilitimi, kam marrë në konsideratë moshën e vajzave të mitura dhe gjendjen shëndetësore të njëres prej tyre, gjendjen shëndetësore të prindërve të tij, qëndrimin e tij pohues dhe pendues deri në atë fazë të hetimit dhe gjykimi, si dhe personalitetin e tij ku rezultonte pa precedent të mëparshëm penal.

Në vijim ndaj këtij shtetasi çështja ka shkuar për gjykim në themel dhe një gjyqtar tjetër i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka zgjidhur çështjen në themel duke e deklaruar fajtor të pandehurin dhe duke caktuar ndaj tij dënimin përfundimtar prej 5 vjet burgim dhe në aplikim të nenit 59 të K.Penal ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të dënimit duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe prej 5 vjetësh me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë vepër tjetër penale. Nga pjesa përshkruese – arsyetuese e vendimit të themelit rezulton se gjyqtari i themelit bazuar në provat që ishin marrë në shqyrtim në seancën e zëvendësimit të masës së sigurimit, ka vlerësuar se ai nuk duhet të vazhonte vuajtjen e dënimit në formën e tij klasike në burgim siç edhe kishte kërkuar organi prokurorisë, por duhet të pezullohej dënimi i tij dhe ai të qëndronte në liri për shkaqë shëndetësore dhe familjare.

Pra duket se shkaqet shëndetësore dhe familjare të analizuara në seancën e zëvendësimit të masës së sigurimit qëndronin dhe kanë qenë të bazuara në nivel të tillë që atij një ditë i sollën lirinë në mënyrë definitive.

Gjithashtu në denoncim pretendohet se M.B është i skeduar për trafik narkotikësh, ndërkohë që nga gjithë provat e administruara në dosje ai rezulton ipandënuar më parë. Pretendohet se atij i është sekuestruar një sasi e madhe lëndë narkotike ndërkohë që i është sekuestruar vetëm 140 gram lëndë narkotike. Ndoshta denoncuesi ngatërron njësitë matëse gram me kilogram. Pretendon se unë e lirova pasi gjoja ka fëmijë të sëmurë, ndërkohë që ky fakt është i provuar në gjykim me prova shkresore. Pretendon se kam rrëzuar përgjimet e prokurorisë me qëllim për ta liruar atë. Edhe ky pretendim është një falsitet i stisur pasi është e vërtetë që me vendimin nr.***, datë 18.12.2020 kam vendosur paligjshmërinë e përgjimit të organit të akuzës për përgjimin e numrit të telefonit të një shtetasi që kishte shkëmbyer sms me të pandehurin i cili dyshohej në rolin e bashkëpunëtorit. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës. Fakti që këto përgjime nuk kanë patur asnjë ndikim dhe asnjë vlerë në hetime provohet në përfundim të rezultatit të hetimeve pas kryerjes së të gjitha veprimeve hetimore ku rezultoi se i pandehuri M.B e ka kryer veprën i vetëm dhe jo në bashkëpunim, si dhe ka shkuar për gjykim sipas nenit 283/1 të K. Penal dhe jo për 283/2. Kjo vërteton faktin se përgjimi i prokurorisë për bashkëpunëtorin e pretenduar ishte i paligjshëm, ashtu siç u konstatua nga unë dhe u konfirmua më pas nga Gjykata e Apelit. Pretendimet në lidhje me marrjen e ryshfetit për këtë çështje janë tërësisht shpifje e ulët dhe aludime të personave dashakeq pa u bazuar në asnjë provë, të cilët duan vetëm të dëmtojnë imazhin dhe karrieren time profesionale.

Nëse do kishin qenë të bazuara këto pretendime atëherë minimalisht do kishte prova konkrete kundër meje, duke qenë se sinjalizimet lidhur me të janë dhënë ende pa filluar shqyrtimi gjyqësor i çështjes. Fakti që nuk është gjetur asnjë provë kundër meje tregon se kam qenë korrekte dhe nuk kam shkelur në asnjë moment ligjin. Përkundrazi kam vepruar vetëm duke u bazuar në ligj dhe në prova.

Subjekti ka depozituar në cilësinë e provave mbështetëse:

- Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr.*** dt 22.07.2021 të dënimit në themel të të pandehurit M.B.
- Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan Nr.***, dt 19.12.2019.
- Procesvebalin e seancës gjyqësore dt 19.12.2020 për caktimin e masës së sigurimit.
- Shkresa nr.*** Prot, dt 02.11.2021 leshuar nga Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tirane për procedimin penal të DSIK.

Sa më sipër, pas kryqëzimit të dy komponentëve të pastërtisë së figurës dhe atë profesional rezulton se:

- i. Faktet e denoncuar nuk qendrojnë dhe nuk u vertetuan, në asnjë pretendim të tyre,
- ii. Të gjitha vendimarrjet e mia janë në përputhje me provat e administruara gjate gjykimit dhe me percaktimet e ligjore,
- iii. Nuk eshte identifikuar asnje kontakt i papershtatshem imi me persona te perfshire ne krimin e organizuar, sipas percaktimeve te Nenit DH te Aneksit te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise,
- iv. Nuk ekziston asnje prove apo rrethane nga ato qe mund te merren parasysh nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm i subjektit te rivleresimit, me një person të përfshirë në krimin e organizuar, sipas percaktimeve te nenit 38 pika 4 te Ligjit Nr.84/2016,
- v. Nuk eshte vertetuar as me dokumenta dhe nuk gjen mbeshtetje as nga vendimarrjet e mia të kem shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar, apo të kem favorizuar avokat apo palë në gjykim,

ç/2 Unë pakica, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, provave të administruara por edhe në referencë të të gjithë hetimit të kryer në lidhje me këtë çështje, konstatoj se subjekti ka synuar të argumentojë bindshëm vendimarrjen e saj duke përfshirë përveçse vlerësimit dhe shqyrtimit të provave edhe bindjen e saj të brendshme në zëvendësimin e masës së sigurimit. Në një vlerësim ligjor është mëse e pranuar që marrja e masës së sigurimit jepet në kushte ngutshmërie, për shkak të nevojës urgjente që prezanton por edhe të afatit ligjor brenda të cilit ajo duhet marrë, dhe jo detyrimisht bashkëshoqërohet me prova e rrethana shteruese, që do të thotë që një masë tjetër zëvendësuese detyrimisht i lejon të dyshuarit të provojë të kundërtën apo lehtësimin e pozitës, sikurse i lejon, pra i jep kohë gjykatës të verifikojë provat e depozituara dhe më tej të vlerësojë qëndrimin mbi to. Nga ana tjetër, në kushtet kur rezulton se në këtë çështje ka rënë akuza e bashkëpunimit⁴⁴ atëherë padyshim që pozita e një të dyshuari dhe jo vetëm, lehtësohet, çka krijon premisa për të vijuar shqyrtimin dhe analizimin e provave në këndvështrim të kriterëve të kërkuara nga legjislacioni për arritjen në zëvendësimin e një mase sigurimi. Provat e siguruara nga i dyshuari nga institucionet publike të cilat përgjithësisht identifikojnë kushtet dhe rrethanat familjare⁴⁵, ekonomike, sociale dhe shëndetësore, janë bërë objekti i arsytimit të vendimit të zëvendësimit të masës së sigurimit krahasuar me vendimarrjen e masës së sigurimit “arrest me burg”, çka hedh dritë edhe mbi disponibilitetin e tyre apo depozitimin pas marrjes së masës së parë të sigurimit. Egzistenciale mbetet argumenti i paraqitur nga Gjykata e Apelit për ndryshimin e vendimit të dhënë nga subjekti, ku thuhet *se çështja është regjistruar dhe për të ka një çështje penale gati për gjykim, pasi në fillimin e muajit mars 2021 janë mbyllur hetimit dhe është kërkuar dërgimi i çështjes në gjyq*, por nga ana tjetër duke iu referuar akteve të administruara në dosjen objekt shqyrtimi vërehet se krahas vendimit për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës bërë në datë 10 mars 2020, në datë 12 mars të po këtij viti, pra pas dy ditëve, po organi i akuzës ka vendosur *zgjatjen*

⁴⁴ Pasqyruar edhe në vendimin e organit të akuzës/Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, “Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës”, datë 10.03.2021.

⁴⁵ Vërtetim datë 30.12.2020 i Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Vërtetim datë 18.12.2021, po nga kjo drejtori, certifikatë familjare.

e afatit të hetimit me tre muaj deri në qershor 2020⁴⁶. Në tilla kushte ky është një element më shumë për të kuptuar që vendimarrja e subjektit nuk ndikohej nga një tjetër situatë. Megjithatë, përdorimi i vendimarrjes, e cila ka ndryshuar zëvendësimin e masës së sigurimit, nuk duket se mund të ngrihet në nivelin e vlerësimit profesional të subjektit duke mbajtur në këtë rast në konsideratë edhe faktin që vendimarrja e themelit ka rezultuar sërish në pezullimin e dënimit ndaj këtij shtetasi duke e vënë në provë për të njëjtën periudhë dënimi me qëllim moskryerjen e një vepre tjetër penale.

Çmoj gjithashtu, se në rastin konkret ndodhemi përpara parashikimit të nenit 72 pika 4 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “4. Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”. Të njëjtin qëndrim mban edhe Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimin nr.*** dt 13.07.2020 i cili arsyeton se: “Sipas vlerësimit të Kolegjit, përcaktimi nëse bindja e brendshme e trupit gjykues rreth dyshimit të arsyeshëm, në rastin konkret, ka qenë e duhura apo e drejta, del jashtë kompetencave të organeve të rivlerësimit, për sa kohë lidhet drejtpërdrejt me korrektësinë e vendimarrjes bazuar në bindjen e brendshme, pra me atë aspekt të aftësive profesionale të magistratëve që nuk mund të gjykohej e të shërbejë si matës i aftësive të tyre profesionale në kuadër të këtij procesi. Arsyetimi i mësipërm gjen mbështetje në nenin 44, paragrafi 1 i ligjit nr. 84/2016, i cili referon te kriteret e ligjit nr.96/2016, si kriteret që duhen analizuar në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve, i cili në referencë të fundit, sipas nenit 72, pika 4 e këtij ligji, ndalon vlerësuesin të çmojë aftësitë gjyqësore duke gjykuar korrektësinë e vendimarrjes apo themelin e çështjes. Për pasojë, në përfundim të këtij arsyetimi, Kolegji çmon se shkeljet e trajtuara se janë kryer nga subjekti në gjykimin e kësaj çështje, të lidhura ngushtësisht në rastin konkret me bindjen e brendshme të magistratit, nuk mund të shërbejnë si gjetje të cilat duhet të analizohen në këndvështrim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit...”.

- Unë komisionere në pakicë, mbi faktet dhe provat e arsyetuara, si dhe në referim të legjislacionit të cituar më sipër, vlerësoj se nuk u konstatua ndonjë problematikë që mund të ndikojë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

6. Në vlerësimin tim si pakicë, konkludoj se në procesin e rivlerësimit të këtij subjekti:

- nuk evidentohen problematika të tilla që mund të çenojnë kriteret e rivlerësimit,
- nuk evidentohen elementë të arsyeshëm, të konsiderueshëm apo të perceptueshëm që mund të çenojnë besimin e publikut, sipas pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr.84/2016,
- nuk mund të ndëshkohet disiplinarisht subjekti në mënyrë të përsëritur për të njëjtën çështje.

7. Përfundimisht si komisionere në pakicë kam konkluduar se pas një vlerësimi tërësor të të tre kriterëve subjekti i rivlerësimit Enkeleda Kapedani me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, duhet të ishte konfirmuar në detyrë, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Brunilda BEKTESHI
Anëtare (kundër)

⁴⁶ Referuar vendimit përkatës datë 12.03.2020, pasqyruar në dosjen që i përket vendimit të zëvendësimit të masës së sigurimit personal, në fq me nr. 98.

